



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 469 Akti

Nr. 524 Vendimi
Tiranë, më 8.4.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 6.4.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elfrida Bregova**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, pas zhvillimit të procedurës së shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, më 16.12.2019, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Elfrida Bregova.
5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Elfrida Bregova nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. ILDKPKI-ja dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- b) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, për të identifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin², në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së znj. Elfrida Bregova.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriteret e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 17.3.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Në datën 18.3.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit të zhvilluar kryesisht nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 23.3.2022, ndërsa më 1.4.2022 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.8.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2021.

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 1.4.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 4.4.2022.

18. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 6.4.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

19. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Elfrida Bregova ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese⁵ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar pranë Komisionit; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Tokë arë⁶, me sipërfaqe 2,225 m², e ndodhur në K, Librazhd, me vlerë 100,000 lekë, në të cilën subjekti zotëron 20% me anëtarët e trungut të saj familjar dhe 50% të 20% me bashkëshortin

24.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kjo pasuri është fituar me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2004, me palë shitëse V.B dhe familja e tij bujqësore dhe blerës T.B, L.B, Sh.B, S.B dhe J.B. Burim i krijimit janë të ardhurat familjare të blerësve.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Subjekti nuk ka paraqitur kontratë për fitimin e bashkëpronësisë nga bashkëshorti, të tokës arë me sip. 2,225 m², në K, Librazhd.

Hetimi⁷/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni për këtë pasuri

24.2. Bashkëshorti i subjektit dhe familjarët e tij⁸, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 26.11.2004, kanë blerë nga shitësit V, K, S, S dhe V.B pasurinë “arë” me sip. 2,225 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në K, Librazhd, për çmimin 100,000 lekë. Në përmbajtje të kontratës shitësit deklarojnë se janë likuiduar jashtë zyrës noteriale.

24.2.1. Bazuar në kartelën e pasurisë së gjeneruar nga sistemi elektronik i ASHK-së rezultojnë se pasuria është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve T.B, L.B, Sh.B, S.B dhe J.B, me nr. pasurie *** dhe sipërfaqe totale 2,225 m².

24.3. Nga verifikimi i DVP-ve vjetore rezultojnë se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratimet e saj periodike nga marrja e detyrës e në vijim. Ndërkohë, bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2007, me përshkrimin “tokë bujqësore me sip. 2,224 m², vendndodhja K, Librazhd, e

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën certifikatën për vërtetim pronësie, datë 1.12.2004, për tokë arë me sip. 2,225 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. *, f.**, në bashkëpronësi të 5 familjarëve B (T, L, Sh, S dhe J).

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2021, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 24.4.2021, e ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.2.2020, e ASHK-së Librazhd; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar ASHK-së Librazhd; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.9.2021, e ASHK-së Librazhd.

⁸ Shtetasit T.B, L.B, Sh.B dhe J.B.

pavlerësuar”, nga e cila zotëron 1/5 pjesë takuese ose 20% të pronës. Bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

24.4. Në procesverbalin e shpjegimeve në deklarimin e pasurive pranë ILDKPKI-së në vitin 2016⁹, në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar: *“Kjo pronë është përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.1.2002. Nuk përfitojmë asnjë të ardhur nga kjo pronë dhe statusi i saj nuk ka ndryshuar”*.

Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të saj në ILDKPKI një kopje të kontratës së shitjes datë 7.1.2002, në të cilën palë shitëse rezultojnë bashkëpronarët V, K, M, S dhe S.B, ndërsa palë blerëse T.B. Bashkëshorti i subjektit nuk rezulton të jetë palë blerëse në këtë kontratë.

Çmimi i shitjes i përcaktuar në këtë kontratë është 100,000 lekë dhe shitësi deklaron të jetë likuiduar për këtë vlerë jashtë zyrës noteriale. Kontrata e shitjes rezulton e panënshkruar nga pala blerëse T.B.

24.5. Në lidhje me këtë pasuri dhe me mënyrën e përfitimit të pjesës së saj takuese, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 20.9.2021, subjekti ka sqaruar: *“Toka për të cilën bëhet fjalë është tokë bujqësore, e cila ndodhet në K, Librazhd, që është fshati i lindjes së babait të bashkëshortit tim. Babai i bashkëshortit, i quajtur T. B, nuk ka përfituar tokë bujqësore sipas ligjit, pasi nuk ka qenë banues në fshat. Gjyshi i bashkëshortit, duke dashur që djali i tij, si dhe nipërit, të mos humbnin lidhjet me fshatin, ka biseduar me djalin e tij V. B, tek i cili jetonte, që një pjesë të tokës së tij bujqësore të përfituar nga ndarja e tokës në fshat, t’ia kalonte babait të bashkëshortit tim T.B dhe fëmijëve të tij [...]. Unë nuk kam pasur dijeni në lidhje me këtë tokë në momentin që kam filluar të deklaroj pasurinë për shkak të detyrës time...*

*Në vitin 2016, kur kemi dhënë shpjegime në ILDKPKI, na është kërkuar informacion për mënyrën e përfitimit të pronësisë së kësaj toke. Bashkëshorti im ka komunikuar me babain e tij T. B dhe i ka kërkuar dokumentet që ai dispononte në banesë për këtë tokë. Babai i tij i ka dhënë një kopje të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.1.2002, ku blerës figuronte vetëm shtetasi T. B. Ky dokument është dorëzuar në ILDKPKI. Në momentin që kemi plotësuar deklaratën Vetting dhe duke qenë se dispononim vetëm kopje të certifikatës së pronësisë së tokës, duke pasur dhe volum dokumentacioni që duhej të siguronim si brenda dhe nga jashtë shtetit, bashkëshorti ka komunikuar përsëri me babain e tij, duke qenë se ai jeton në Librazhd, që të merrte një kopje të kontratës së shitblerjes së pronës për ta pasqyruar në deklaratë. Babai i ka dhënë bashkëshortit të dhënat lidhur me numrin e repertorit dhe koleksionit të kontratës me të cilën ishte kryer regjistrimi i pronës në zyrën e kadastrës, kontratë, e cila ishte lidhur në vitin 2004. Këtë dokument ne nuk e kemi pasur në dispozicion dhe për këtë arsye nuk e kemi dorëzuar me deklaratën Vetting. Kemi dorëzuar vetëm certifikatën e pronësisë së tokës [...]. Pas pyetësorit të sjellë nga ana juaj, bashkëshorti im ka aplikuar në portalin e-albania lidhur me praktikën e plotë të regjistrimit të pasurisë tokë arë me sipërfaqe 2,225 m², nr. pasurie ***, zona kadastrale ***. Pasi ka administruar praktikën, konkretisht kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2004, bashkëshorti ka konstatuar se rezultonte edhe ai blerës në këtë kontratë, në një kohë që nuk ka qenë fare në Shqipëri, ka qenë jashtë shtetit në Itali. Pas këtij konstatimi, bashkëshorti ka biseduar me babain e tij, i cili i ka shpjeguar që të gjitha dokumentet i ka bërë ai me qëllim që të gjithë fëmijët të kishin lidhje me fshatin e tij të origjinës. Vlëra e plotë e kësaj toke në shumën 100,000 lekë është paguar nga të ardhurat e familjes së z. T.B.*

Në kushtet kur mësova se kontrata e shitjes nuk është nënshkruar nga bashkëshorti im dhe si e tillë ajo formalisht është e falsifikuar, kam paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Bashkëlidhur kopje të kallëzimit të paraqitur [...] Babai

⁹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2021, të ILDKPKI-së.

i bashkëshortit na ka shpjeguar se nuk ka regjistruar kontratën e vitit 2002, ku ai ishte blerës i vetëm i kësaj pasurie, por kontratën e vitit 2004, sipas shpjegimit të sipërcituar. Kjo pasuri nuk është përdorur asnjëherë nga ana ime dhe e bashkëshortit tim. Në këtë sipërfaqe toke nuk ka asnjë ndërtime. Kjo duket edhe në fotot bashkëlidhur të marra nga google earth. Në këtë tokë nuk janë kryer asnjëherë punime bujqësore dhe nuk është marrë asnjëherë asnjë prodhim”.

24.6. Bashkëlidhur pyetësorit nr. 1, datë 20.9.2021, subjekti ka paraqitur:

- kopje të kallëzimit penal, me kallëzuese Elfrida Bregova dhe të kallëzuar noter K.K, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe veprën penale “falsifikim i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal;
- imazhe satelitore dhe ortofoto të pasurisë “arë”, të ndodhur në K, Librazhd;
- vërtetime nga Njësia Administrative Librazhd lidhur me përfitimet nga statusi i të verbrit, si dhe përfitimet nga statusi i invalidit për shtetasin T.B;
- vërtetim nga ISSH-ja lidhur me të ardhurat e përfituara nga shtetasi T. B për periudhën 1.1.1994 – 31.1.2001;
- certifikatat familjare të cilat vërtetojnë marrëdhënien e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me bashkëpronarët e pasurisë “arë”, të ndodhur në K, Librazhd.

24.7. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, vlerëson se ato janë bindëse. Në lidhje me faktin e mosdeklarimit të kësaj pasurie nga subjekti në deklaratat periodike, Komisioni, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹⁰, si dhe duke marrë në konsideratë: (i) vlerën e ulët të blerjes së kësaj toke; (ii) pjesën takuese të bashkëshortit (20%); (iii) faktin që kjo pasuri është në bashkëpronësi të të gjithë familjes së bashkëshortit; (iv) deklarimit të bashkëshortit të kësaj pasurie në deklaratat periodike; (v) deklarimin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*; dhe (vi) faktin që kjo pasuri nuk ka prodhuar të ardhura – vlerëson se kjo pasaktësi, e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme, nuk mund të konsiderohet si shkak që mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit, duke mos u konsideruar si deklarim i pasaktë, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Tabela nr. 1 – analiza financiare për blerjen e pasurisë nga shtetasi T. B

	Datë 26.11.2004
Pasuria	100,000.00
Tokë arë, me sip. 2225 m ² , K, Librazhd	100,000.00
Detyrime	0.00
Pasuria neto	100,000.00
Të ardhura	926,335.00
Të ardhurat e z. T. B, vitet 1994 - 2001, nga punësimi në Qendrën Kulturore Librazhd	774,535.00
Të ardhura nga trajtimi me pension invaliditeti, periudha 2001 – 26.11.2004	151,800.00
Shpenzime	816,904.19
Shpenzime jetike, vitet 1994 - 2000	326,912.52
Shpenzime jetike, periudha 2000 – 26.11.2004	489,991.67
Mundësia për kursime	9,430.81

24.8. Nga analiza financiare rezultoi se shtetasi T.B ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

¹⁰ Vendimet nr. 37/2021; nr. 9/2020; nr. 16/2020; dhe nr. 31/2020.

24.9. Për sa më sipër, arrihet në përfundimin se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit.

25. Apartament¹¹ me sipërfaqe 87.3 m² dhe verandë me sipërfaqe 73.5 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, me adresë: rruga “F.P”, ish-K.P, Tiranë, me vlerë 104,000 euro. Pjesa takuese: 50%.**

25.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: (i) depozitë bankare datë 4.7.2012, në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 3,000,000 lekë, në emër të shtetasit S.B; (ii) hua e marrë nga shtetasi P. G, në vlerën 50,000 euro; (iii) hua e marrë nga shtetasi I. H, në vlerën 3,000,000 lekë; si dhe (iv) hua e marrë nga shtetasi S.A, në vlerën 1,200,000 lekë.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Deklarim i rremë nga subjekti Elfrida Bregova lidhur me pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në rrugën “F.P”, Tiranë, pasi të dhënat nga dokumentacioni i administruar lidhur me shumën e paguara dhe datat e pagesës janë kontradiktore, sipas kontratës së shitjes, në datën 27.7.2012 është likuiduar çmimi 104,000 euro, ndërsa pagesa prej 7,000 euro bëhet në datën 29.7.2012, si këst i fundit.
- Pagesat e kryera ndaj shoqërisë “H” sh.p.k., sipas DPPP-së, për blerje apartamenti, të kryera në periudhën nëntor – dhjetor 2012 në shumën 88,609 euro, si dhe derdhja në BKT për likuidim kësti apartamenti në shumën 21,493 euro, nuk përkojnë me deklarin e kryer nga subjekti, rrjedhimisht subjekti ka bërë deklarin të rremë lidhur me vlerën e paguar për apartamentin dhe/ose ka fshehje të pagesave gjatë periudhës së konfirmuar dhe qëllimit të tyre gjithashtu.
- Subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të huadhënësit P.G, por ka paraqitur ekstraktin historik të QKR-së për aktivitetin e regjistruar në emër të tij, si dhe tërheqjen e shumave monetare nga llogaria e shoqërisë.
- Deklarim i rremë lidhur me burimin financiar të huadhënësit P.G, të pretenduar nga shtetasi S. B, pasi palët deklarojnë burime të ndryshme. Marrja e shumës 50,000 euro nuk është nëpërmjet sistemit bankar.
- Subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të huadhënësit, por ka paraqitur nxjerrje llogarie të tij, në të cilat evidentohen kreditimet nga paga. Vërehet dypunësim i tij për periudhën 2012 – 2013.
- Subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të huadhënësit I.H për shumën 3,000,000 lekë, por ka paraqitur nxjerrje llogarie të tij, në të cilat evidentohen kreditimet nga paga apo përfaqësimet e këtij shtetasi për llogari të shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k., të cilat nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar aftësinë e tij financiare për të dhënë hua. Gjithashtu, ka paraqitur ekstraktin historik për regjistrimin e huadhënësit I. H për aktivitet si person fizik, i cili mban datën 18.4.2013, periudhë jo e vlefshme për justifikimin e burimit të shumës së huas prej 3,000,000 lekësh, dhënë në vitin 2012. Huamarrja dhe kthimi i saj janë jashtë sistemit bankar.
- Mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit në rrugën “F.P”, Tiranë, i cili është financuar 3,000,000 lekë nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit, ndërsa pjesa tjetër me huamarrje në shumën 50,000 euro, 3,000,000 lekë dhe 1,200,000 lekë, të cilat mbeten të dyshimta dhe të paargumentuara.

¹¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.7.2012; (ii) kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 4.7.2012; (iii) dy shkresa me nr. ***, datë 4.7.2012, të shoqërisë “H” sh.p.k., për modalitetet e pagesës për apartament nr. **; (iv) shkresë të thjeshtë “arkëtim”; si dhe (v) mandatarkëtimin nr.**, datë 4.7.2012, të shoqërisë “H” sh.p.k., për pagesë nga shtetasi S.B të shumës 97,000 euro, për apartamentin nr. ***.

Hetimi¹²/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni për këtë pasuri

25.2. Bashkëshorti i subjektit, me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 4.7.2012, ka porositur nga shoqëria “H” sh.p.k. apartament banimi në rrugën “F.P”, Tiranë, me sipërfaqe banimi 87.3 m², sipërfaqe të përbashkët 11.9 m² dhe sipërfaqe verande 73.5 m², në vlerën 104,000 euro.

Sipas aneksit të kontratës së sipërmarrjes, çmimi për metër katror i sipërfaqes së brendshme të apartamentit është 765 euro, ndërsa për verandën është 382.5 euro.

Në nenin 13.2. të kontratës përcaktohet se pagesa e çmimit do të bëhet në këtë mënyrë: shuma 97,000 euro do të paguhet me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes; dhe shuma 7,000 euro do të paguhet me dorëzimin e hipotekës.

25.3. Për të provuar pagimin e çmimit të apartamentit, subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar:

- mandatarkëtimin nr. **, datë 4.7.2012, sipas të cilit bashkëshorti ka paguar *cash* shumën 97,000 euro;
- shkresë të thjeshtë “arkëtim”, sipas së cilës bashkëshorti ka depozituar në datën 29.7.2012 shumën 7,000 euro, për këstin e fundit të ZVRPP-së, me vulë nga *S.M.A.*

Në datën 27.7.2012 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitblerjes nr. *** për blerjen e këtij apartamentit¹³. Në nenin 2 të kontratës përcaktohet se çmimi i shitjes është paguar totalisht nga blerësi përpara lidhjes së kontratës dhe shitësi nuk ka më pretendime për të. Apartamenti është marrë në dorëzim nga bashkëshorti i subjektit në datën 5.7.2012, bazuar në deklaratën për marrjen në dorëzim nr. *** prot.¹⁴.

25.4. Në deklaratën periodike të vitit 2012 subjekti e ka deklaruar si vijon këtë pasuri: shtëpi banimi me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 87.3 m² dhe verandë me sip. 73.5m², me adresë: rruga “F.P”, Tiranë, me vlerë 104,000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: (i) tërheqje depozite bankare, datë 4.7.2012, në “Raiffeisen Bank” në emër të shtetasit S.B, në vlerën 3,000,000 lekë. (ii) huamarrje në vlerën 50,000 euro; (iii) huamarrje në vlerën 3,000,000 lekë; dhe (iv) huamarrje në vlerën 1,200,000 lekë.

Hetimi i Komisionit në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie

25.5. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e vitit 2016 pranë ILDKPKI-së¹⁵ lidhur me pagesat e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, ka deklaruar: “*Transaksioni është kryer në zyrat e kompanisë ndërtuese dhe për këtë po paraqes mandatpagesat me nr. ***”

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.2.2020, e ASHK-së; shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2021, drejtuar OSHEE-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.6.2021, e OSHEE-së; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar OSHEE-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.7.2021, e OSHEE-së; shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar OSHEE-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e OSHEE-së; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-*** prot., datë 5.10.2021, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2021, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-***prot., datë 18.6.2021, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2021, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2021, e ILDKPKI-së.

¹³ Nr. pasurie ***, z. k. ***.

¹⁴ Shihni kthim përgjigjen në pyetësorin datë 20.9.2021.

¹⁵ Kërkesë nr. *** prot., datë 20.4.2021, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2021.

, datë 4.7.2012 dhe datë 29.7.2012”. Nga analizimi i këtyre mandatpagesave rezulton se ato janë të njëjta me mandatet e paraqitura nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

25.6. Nga hetimi ka rezultuar se:

- Bashkëshorti i subjektit ka kryer një depozitim prej 21,493 euro në BKT, me përshkrimin “për likuidim kësti blerje apartamenti me nr. ***, në datën 3.12.2012”.
- Ka 7 raportime nga shoqëria “H” sh.p.k. për pagesë kësti gjatë muajve nëntor – dhjetor 2012 në shumën totale 88,609 euro, nga shtetasi S.B për blerje apartamenti.

Në kushtet kur nga hetimi rezultoi mospërputhje në lidhje me pagesat e kryera për këtë apartament, Komisioni ka kryer verifikimet përmes kërkesës drejtuar shoqërisë shitëse “H” sh.p.k., BKT-së dhe “Credins Bank”.

i. Në përgjigjen¹⁶ e saj, shoqëria “H” sh.p.k. informon se: *“Klienti S.B ka prenotuar sipas kontratës së sipërmarrjes apartamentin me nr. *** pranë objektit H. Me dorëzimin e dokumentacionit pranë hipotekës, numërtimi i apartamentit ka ndryshuar nga nr. *** në nr. ** dhe me nr. ** është përgatitur dhe nënshkruar kontrata e shitjes përfundimtare për apartamentin e prenotuar. Pagesa për këtë apartament është kryer me këste në llogarinë bankare të subjektit H dhe asnjë këst nuk është paguar cash (me para në dorë) në arkën e subjektit”.*

Shoqëria “H” sh.p.k. i ka bashkëlidhur përgjigjes së saj dokumentin “kartelë llogarie” në të cilin evidentohen pagesat e kryera nga blerësi i pasurisë S.B, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 2

Data	Banka	Vlera e paguar (në euro)
30.7.2012	Credins	7,000
31.10.2012	Credins	4,450
6.11.2012	Credins	5,500
7.11.2012	Credins	10,000
15.11.2012	Credins	4,000
19.11.2012	Credins	10,000
26.11.2012	Credins	10,000
3.12.2012	BKT	21,493.55
11.12.2012	Credins	27,000
12.12.2012	Credins	4,616

Kjo shoqëri ka paraqitur gjithashtu dokumentin “deklaratë për marrjen në dorëzim të njësisë ****” me nr. *** prot., datë 5.7.2012, në të cilin blerësi S.B deklaron se ka kryer pagesën e shumës 97,000 euro dhe diferencën prej 7,000 euro do t’i paguajë pasi të pajiset me dokumentin nga ZVRPP-ja. Përmes kësaj deklarate bashkëshorti i subjektit ka marrë në dorëzim apartamentin e porositur.

Komisioni ka evidentuar mospërputhje në përmbajtje të përgjigjes së dërguar nga shoqëria “H” sh.p.k. dhe dokumentacionit bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, lidhur me pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit për blerjen e apartamentit. Për këtë arsye, Komisioni i ka kërkuar kësaj shoqërie sqarime të mëtejshme. Në përgjigjen e saj, shoqëria “H” sh.p.k. informon se: *“Nga*

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2021 drejtuar shoqërisë “H” sh.p.k.; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2021, e shoqërisë “H” sh.p.k.; shkresë nr. *** prot., datë 23.6.2021, drejtuar shoqërisë “H” sh.p.k.; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.6.2021, e shoqërisë “H” sh.p.k.

verifikimi i dokumentacionit përkatës të kësaj praktike shiteje rezulton se pagesat në llogarinë bankare të shoqërisë janë kryer nga vetë z. B”.

ii. Në përgjigjen¹⁷ e saj, BKT-ja konfirmon se në llogarinë e shoqërisë “H” sh.p.k. në monedhën euro është evidentuar veprimi me referencë ***, datë 3.12.2012, i cili në përshkrim të tij ka të cilësuar “S. B derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. *** (vlera totale 21,500 euro – komisioni 0,03%, në vlerën 21,493.55 euro”.

iii. Në përgjigjen¹⁸ e saj, “Credins Bank” konfirmon se shtetasi S.B ka kryer kreditime në llogari të subjektit “H” sh.p.k., për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2013, në shumën totale 82,566.00 euro.

Kreditimet e cituara në përgjigjen e kësaj banke rezultojnë në përputhje me dokumentin “kartelë llogarie” të depozituar në Komision nga shoqëria “H” sh.p.k.

25.7. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 20.9.2021, në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar: “Të vetmet pagesa që janë bërë nga bashkëshorti janë ato të kryera cash në dy këste.

*Për sa i përket konstatimit tuaj se në llogarinë e shoqërisë ‘H’ sh.p.k. në BKT në monedhën euro është evidentuar veprimi me referencë ***, datë 3.12.2012, i cili në përshkrim të tij ka të cilësuar ‘S.B derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. *** (vlera totale 21,500 euro – komisioni 0,03%, në vlerën 21,493.55 euro’, ju sqaroj se është kërkuar në BKT praktika lidhur me veprimin me referencë ***, datë 3.12.2012. Nga BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.9.2021, është kthyer përgjigje, duke na vënë në dispozicion fotokopjen e praktikës e cila ndodhet në arkivën e kësaj banke, konkretisht dokumentet ‘depozitim në cash jo titullare’, datë 3.12.2012, shuma neto 21,493.55 euro, me përshkrim ‘derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. ***’ dhe mandatarkëtimi datë 3.12.2012, në shumën 21,493.55 euro, si këst apartamenti ***. Të dy këto mandate kishin urdhërues S. B.*

Pasi u njoha me këto dokumente, si unë dhe bashkëshorti im konstatoam se shkrimi emër mbiemër S.B, si dhe nënshkrimi, nuk ishin shkrimi dhe nënshkrimi i bashkëshortit tim. Të ndodhur në këto kushte, duke qenë se dokumentet ishin të falsifikuara, bashkëshorti i ka kërkuar një ekspert privat që të kryejë një aktekspertimi grafik. Nga akti i ekspertimit grafik, datë 30.9.2021, ka rezultuar se: dy nënshkrimet e plota emër mbiemër firmë, të shkruara në emër të S.B, në fund të dy dokumenteve bankare objekt ekspertimi, nuk janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi S.B; dy nënshkrimet e plota emër, mbiemër, firmë, të shkruara në fund të dy dokumenteve bankare, objekt ekspertimi, janë shkruar nga i njëjti person. Firmat në këto dy nënshkrime janë të sajuara grafiksht; dy nënshkrimet objekt ekspertimi përmbajnë gjurmë me vlera që identifikojnë autorin e tyre.

*Nga përgjigja e ardhur nga ‘Credins Bank’ me nr. *** prot., datë 1.10.2021, rezulton se nga periudha korrik 2012 dhe deri në dhjetor 2012 në llogarinë e shoqërisë ‘H’ sh.p.k. janë kryer tetë derdhje, me përshkrimin ‘S.B likuidim këst apartamenti ***’, me datat dhe vlerat si më poshtë.*

*- Mandati datë 30.7.2012, derdhje 7,000 euro, me përshkrimin ‘S.B këst hipoteke ap. ***’, me depozituese dhe nënshkruar nga znj. O, mbiemri i palexueshëm.*

*- Mandatet datë 31.10.2012, datë 6.11.2012, datë 7.11.2012, datë 19.11.2012, datë 26.11.2012, datë 11.12.2012 dhe datë 12.12.2012, me përshkrimin ‘derdhje S.B këst apartamenti ***’, me depozituese dhe nënshkruar nga znj. S.A.*

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2021, drejtuar BKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.6.2021, e BKT-së.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2021, drejtuar “Credins Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.7.2021, e “Credins Bank”.

Në total vlera e depozituar në llogarinë e shoqërisë 'H' është 78,566 euro.

*Nga shkresa kthim përgjigje datë 1.10.2021, e shoqërisë 'H' sh.p.k. rezulton si më poshtë: Vlera e arkëtuar cash në datën 29.7.2012 është pranuar nga subjekti S.M. A, meqenëse zyrat e shoqërisë H kanë qenë të mbyllura atë ditë dhe ditën e nesërme, në datën 30.7.2012, janë regjistruar në arkën e shoqërisë 'H'. Vlera e arkëtuar 97,000 euro sipas mandatarkëtimit nr. **, datë 4.7.2012, është depozituar pjesë-pjesë në ditë të ndryshme nga z. B (si palë, nëpërmjet punonjësve të shoqërisë) si përfaqësuesi i shoqërisë 'H' dhe në përshkrimin e depozitimit janë vendosur të dhënat e kontratës për apartamentin e blerë nga z. B, si dhe emri i z. B për të bërë verifikimin e klientit dhe rakordimin e klientit nga vetë shoqëria”.*

25.8. Bashkëlidhur pyetësorit, subjekti ka paraqitur:

- dokumentacionin e plotë të blerjes së apartamentit nga shoqëria “H” sh.p.k.;
- shkresën kthim përgjigjeje datë 1.10.2021, të shoqërisë “H” sh.p.k.;
- vërtetimin për aktin e realizuar nga zyra noterale e noteres L. P;
- vërtetimin nga ISSH-ja lidhur me pagesat e kontributeve të: shtetases J.N mbi bazën e pagës që ka marrë si e punësuar pranë subjektit “K” sh.p.k. dhe “S.M.A; dhe shtetases S. A e cila rezulton si e punësuar në subjektin “K” sh.p.k. dhe “H” sh.p.k.;
- shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2021, të “Credins Bank” lidhur me veprimet bankare në llogaritë e shoqërisë “H” sh.p.k.;
- shkresën nr. *** prot., datë 24.9.2021, të BKT-së lidhur me veprimin e kryer në datën 3.12.2012 në llogarinë bankare të shoqërisë “H” sh.p.k.;
- aktekspertimin grafik, përgatitur nga eksperti kriminalist V.H.

25.9. Nga analizimi tërësor i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit lidhur me pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të shitjes së apartamentit, rezulton se:

a) Mandati bankar datë 30.7.2012, përmes së cilit është depozituar në “Credins Bank” shuma 7,000 euro, është nënshkruar nga shtetasja O.M dhe nuk mban nënshkrim të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

b) Mandatet bankare të periudhës 31.10.2012 – 12.12.2012, përmes së cilëve është depozituar në “Credins Bank” shuma 75,566 euro, janë nënshkruar nga shtetasja S.A. Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 24.9.2021, të ISSH-së, kjo shtetase rezulton e punësuar pranë subjektit “K” sh.p.k. nga viti 2012 e në vijim.

c) Mandati bankar datë 3.12.2012, përmes së cilit është depozituar në BKT shuma 21,493.55 euro, mban nënshkrimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. S. B.

25.10. Në lidhje me nënshkrimin e vendosur mbi këtë mandat, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i është drejtuar ekspertit kriminalist V.H, me kërkesën për kryerjen e ekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit për të përcaktuar nëse në dokumentacionin bankar i përkasin shtetasit S.B. Në përfundim të ekzaminimit të kryer, eksperti ka konkluduar se *nënshkrimet e shkruara në emër të shtetasit S.B në fund të dy dokumenteve bankare, objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasi S. B.*

Komisioni vlerëson se aktekspertimi i përgatitur nga eksperti kriminalist V.H nuk mund të merret në cilësinë e provës, pasi nuk është kryer mbi dokumentin origjinal, por mbi fotokopje.

Shoqëria “H” sh.p.k., me shkresën kthim përgjigjeje datë 1.10.2021 i ka konfirmuar subjektit dhe bashkëshortit të saj se vlera e arkëtuar në shumën 97,000 euro me mandatarkëtimit nr. **, datë 4.7.2012, është depozituar pjesë-pjesë në ditë të ndryshme nga z. B, si përfaqësues i shoqërisë “H” sh.p.k. dhe në përshkrimin e depozitimit janë vendosur të dhënat e kontratës për apartamentin e blerë nga bashkëshorti i subjektit. Në shkresë shoqëria ka paraqitur edhe kartelën e klientit, ku rezultojnë arkëtimet në datën 4.7.2012 në shumën 97,000 euro dhe në

datën 30.7.2021 në shumën 7,000 euro, si dhe depozitimet e shumës totale 104,000 euro në bankë, sipas datave të konfirmuara nga “Credins Bank” dhe BKT.

25.11. Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti dokumentacion të plotë provues në lidhje me depozitim e shumës 21,493.55 euro, Komisioni e konsideroi si të paguar nga bashkëshorti i saj, pavarësisht se nga dokumentacioni i administruar dukej se kjo shumë ishte pjesë përbërëse e çmimit 104,000 euro të pagesës së kryer *cash* prej tij.

25.12. Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësitë e bashkëshortit të subjektit për kryerjen e kësaj pagese në datën 3.12.2012, duke mos përfshirë në këtë analizë pagesën prej 104,000 euro të kryer në korrik të vitit 2012.

Tabela nr. 3

	Gusht – dhjetor 2012
PASURIA	2,989,660.56 lekë
Pagesë e shumës 21,493.55 euro	3,003,078.81
Ndryshim likuiditeti	-13,418.25
DETYRIME	-8,421.04
Pagesa të kredisë bankare	-8,421.04
PASURIA NETO	2,998,081.60
TË ARDHURA	2,265,303.53
Të ardhurat e subjektit	393,806.25
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit S.B	451,497.92
Dhuratë nga nëna N. B, datë 6.9.2012 (10,000 euro)	1,397,200.00
Të ardhura nga interesa bankare nga depozita	22,799.36
SHPENZIME	231,662.08
Shpenzime jetike	198,662.08
TIMS	0.00
Shpenzime udhëtimi për në vendin e punës të bashkëshortit të subjektit	33,000.00
Mundësia për kursime	-964,440.16

25.13. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e pagesës prej 21,493.55 euro në BKT, në shumën 964,440 lekë.

25.14. Komisioni, duke marrë në konsideratë analizën financiare më lart, i kaloi subjektit barrën e provës, pasi: (i) shuma prej 21,493.55 euro, depozituar në datën 3.12.2012 BKT, duket se është paguar personalisht nga bashkëshorti i subjektit; (ii) subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e pagesës në shumën 21,493.55 euro; si dhe (iii) shuma prej 104,000 euro është paguar *cash* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në arkën e shoqërisë “H” sh.p.k.

25.15. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti parashtrroi si vijon: “*Bazuar edhe në parashikimet kontraktuale, pagesa e plotë e vlerës së apartamentit të porositur është paguar në datën 4.7.2012 dhe në datën 29.7.2012, vërtetuar me mandatarkëtimin nr. **, datë 4.7.2012, sipas së cilit bashkëshorti ka paguar cash shumën 97,000 euro dhe shkresës së thjeshtë “arkëtim”, sipas së cilës bashkëshorti ka depozituar në datën 29.7.2012 shumën 7,000 euro, për këstin e fundit të ZVRPP-së, me vulë nga S.M.A. Ashtu siç është deklaruar gjithmonë gjatë hetimit administrativ, e gjithë vlera e apartamentit është paguar cash dhe nuk është kryer*

asnjëherë pagesa në bankë për blerjen e kësaj pasurie. Në lidhje me pagesat e kryera në bankë, gjatë hetimit administrativ shoqëria përfundimisht ka sqaruar se vlera e arkëtuar prej 97,000 euro me mandatarkëtimin nr. **, datë 4.7.2012, është depozituar pjesë-pjesë në ditë të ndryshme nga z. B, si përfaqësues i shoqërisë 'H' dhe në përshkrimin e depozitimit janë vendosur të dhënat e kontratës për apartamentin e blerë nga bashkëshorti im. Bashkëlidhur informacionit të dërguar, shoqëria ka paraqitur edhe kartelën e klientit, ku rezultojnë arkëtimet cash në datën 4.7.2012 në shumën 97,000 euro dhe në datën 30.7.2021 në shumën 7,000 euro. Depozitimi i shumës 21,493.55 euro është kryer në degën e BKT-së në Tiranë, e cila vuri në dispozicion kopje të dokumentit 'depozitim në cash jo titullare', datë 3.12.2012, në shumën prej 21,493 euro, me përshkrimin 'derdhje për likuidim kësti apartamenti, S.B', si dhe kopje mandatarkëtimi datë 3.12.2012. Duke qenë se dokumentet ishin të falsifikuara, bashkëshorti i ka kërkuar një ekspert të pavarur kriminalist që të kryejë një akt ekspertimi grafik. Nga akti i ekspertimit grafik, datë 30.9.2021, ka rezultuar se: 'Dy nënshkrimet e plota emër, mbiemër, firmë, të shkruara në emër të S.B, në fund të dy dokumenteve bankare, objekt ekspertimi, nuk janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi S.B. Dy nënshkrimet e plota emër, mbiemër, firmë, të shkruara në fund të dy dokumenteve bankare, objekt ekspertimi, janë shkruar nga i njëjti person. Firmat në këto dy nënshkrime janë të sajuara grafikisht. Dy nënshkrimet, objekt ekspertimi, përmbajnë gjurmë me vlera që identifikojnë autorin e tyre'.

Pavarësisht të dhënave të sipërcituara, Komisioni, duke argumentuar se akti i ekspertimit është kryer mbi fotokopje, nuk e ka pranuar shpjegimin e bashkëshortit dhe ka vlerësuar gabimisht se shuma 21,493.55 euro është paguar prej tij.

Sqaroj Komisionin se në vitin 2012 bashkëshorti im ushtronte detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Ai udhëtonte çdo ditë, duke u nisur nga Tirana përpara orës 06:00 dhe kthehej në Tiranë pas orës 18:00. Depozitimi i shumës në bankë, sipas praktikës së bankës, rezultoi të jetë kryer në orën 09:44, ndërkohë që bashkëshorti në orën 09:00 - 09:10 ka qenë në një gjyq në Gjykatën e Rrethit Shkodër, më pas në orën 10:30 ka qenë në një gjyq tjetër dhe në orën 13:00 deri në 13:25 ka qenë në një gjyq tjetër përsëri në Gjykatën e Rrethit Shkodër. Në këto kushte, bashkëshorti e ka pasur të pamundur të ishte njëkohësisht edhe në Shkodër, duke kryer me intensitet punën e tij (atë ditë ka qenë i pranishëm në tri seanca gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Shkodër, seanca të zhvilluara në orën 09:00, në orën 10:30 dhe në orën 13:00, si dhe ka marrë 3 vendime përfundimtare, përveç detyrave të tjera) edhe në Tiranë, që të kryente veprime në BKT. Pra, kjo provë e re, në unitet edhe me të gjitha provat e tjera të administruara gjatë hetimit, provon tej çdo dyshimi të arsyeshëm se bashkëshorti nuk e ka kryer këtë depozitim".

Subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimet e saj, ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga e cila rezultoi se në datën 3.12.2012 bashkëshorti i saj ka qenë i pranishëm dhe ka marrë pjesë në seanca gjyqësore si prokuror për çështjet: nr. ***, me të pandehur P.P, seancë e zhvilluar në datën 3.12.2012 nga ora 09:00 deri në orën 09:10; nr.***, me të pandehur "D.K" sh.p.k., A.U dhe T.Gj, seancë e zhvilluar në datën 3.12.2012, ora 10:30; nr. ***, me të pandehur B.I etj., seancë e zhvilluar në datën 3.12.2012 nga ora 13:00 deri në orën 13:25.
- b. Shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga e cila rezultoi se në datën 3.12.2012 bashkëshorti i subjektit ka qenë në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe gjatë kësaj dite pune ka marrë disa vendime në ushtrim të detyrës së tij, si vijon: kërkesën për

gjykimin e çështjes penale nr. ***; vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***; vendimin për shpalljen e moskompetencës tokësore të çështjes penale nr. ***.

- c. Kopje të kallëzimit penal, datë 25.3.2022 (së bashku me mandatin postar), me kallëzues Elfrida Bregova, të kallëzuar BKT, baza ligjore neni 283 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 248 i Kodit Penal.

25.16. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se:

- i. Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, provohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 3.12.2012: ka marrë pjesë në tri çështje gjyqësore të zhvilluara në oraret 09:00, 10:30 dhe 13:00; si dhe ka përgatitur dokumentet si vijon:
- kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***;
 - vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***;
 - vendimin për shpalljen e moskompetencës tokësore të çështjes penale nr. ***.

Për sa më sipër, rezulton e provuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë në qytetin e Shkodrës, të paktën duke filluar nga ora 09:00 deri në orën 16:30.

- ii. Nga verifikimi i dokumentit “depozitim në *cash*”, i datës 3.12.2012, nëpërmjet të cilit është depozituar shuma 21,493.55 euro, konstatohet se ora e gjeneruar në këtë dokument është 09:44.

Duke iu referuar orës së kryerjes së depozitimit *cash* të shumës 21,493.55 euro, marrë në harmoni me dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ku konstatohet se bashkëshorti i saj ka qenë në qytetin e e Shkodrës nga ora 09:00 deri në orën 16:30, provohet se depozitimi i kësaj shume nuk mund të jetë kryer prej tij.

Duke qenë se prezenca e z. S. B në sallën e gjyqit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në orën 9:00 vërtetohet nga vendimi gjyqësor i kësaj gjykate, Komisioni e vlerëson të pamundur qenien fizikisht të tij në sportelin e BKT-së në Tiranë, në orën 09:44. Kjo pamundësi provohet me distancën e largët ndërmjet dy qyteteve. Për rrjedhojë, shuma 21,493.55 euro nuk do të konsiderohet si e paguar nga bashkëshorti i subjektit, si dhe nuk do të përfshihet në analizën financiare, përveç shumës së provuar si të paguar nëpërmjet mandatpagesave.

25.17. Komisioni ka vlerësuar faktet, si vijon:

- a. Pagesa e shumës 104,000 euro *cash* është kryer nga bashkëshorti i subjektit në datat 4.7.2012 dhe 29.7.2012.
- b. Kontrata e shitblerjes me shoqërinë “H” sh.p.k. është lidhur në datën 27.7.2012. Në nenin 2 të kontratës përcaktohet se çmimi i shitjes është paguar totalisht nga blerësi përpara lidhjes së kontratës dhe shitësi nuk ka më pretendime për të.
- c. Regjistrimi i kësaj pasurie në emër të bashkëshortit të subjektit është bërë në datën 13.8.2012.
- d. Çmimi i përcaktuar në një kontratë të ngjashme në shumën 800 euro¹⁹ është në një vlerë gati të njëjtë me çmimin e blerjes së apartamentit nga bashkëshorti i subjektit.
- e. Depozitimet në “Credins Bank” (të cilat kanë filluar nga data 30.7.2012, kur është depozituar shuma 7,000 euro dhe kanë përfunduar në datën 12.12.2012, kur është depozituar shuma 4,616 euro) nga ana e shoqërisë “H” sh.p.k. kanë filluar pas lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe kryerjes pagesës *cash* të kështit të fundit në shumën 7,000 euro nga bashkëshorti i subjektit.

¹⁹ Në lidhje me këtë çmim referohuni dosjes sekrete të subjektit.

- f. Konfirmimi i shoqërisë “H” sh.p.k. me shkresën e datës 1.10.2021, dërguar subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti ka paguar në total shumën 104,000 euro, e cila është depozituar pjesë-pjesë në bankë nga administratori i shoqërisë.
- g. Shkresa e datës 1.10.2021 e shoqërisë “H” sh.p.k., ku është e përfshirë edhe kartela e klientit sipas kontabilitetit të kësaj shoqërie, në të cilën paraqiten arkëtimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit dhe pagesat që janë depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë për këtë klient, nga ku konstatohet se:
 - bashkëshorti i subjektit ka kryer dy arkëtime *cash* në vlerën totale 104,000 euro;
 - duke filluar nga data 30.7.2012 deri më 12.12.2012 shoqëria “H” sh.p.k. ka depozituar në bankë në total shumën 104,000 euro, ku pjesë përbërëse e këtyre depozitimeve është edhe shuma 21,493.55 euro në datë 3.12.2012, me shënimin “depozitim në BKT nga ekonomisti i shoqërisë ‘H’ sh.p.k.”.
- h. Në “Credins Bank” është depozituar në total shuma 82,566.00 euro. Nëse kësaj shume i shtohet edhe vlera prej 21,493.55 euro, e depozituar në BKT, atëherë rezulton se në total nëpërmjet sistemit bankar është depozituar shuma 104,000 euro, e cila është e njëjta shumë e paguar *cash* nga bashkëshorti i subjektit.
- i. Rezulton e provuar se nuk ka qenë bashkëshorti i subjektit ai që ka kryer pagesën e shumës 21,494.55 euro në BKT në datën 3.12.2012, por ky kreditim, bazuar në shkresën e shoqërisë “H” sh.p.k., është bërë nga ekonomisti i kësaj shoqërie.

25.18. Komisioni, pasi vlerësoi këto fakte dhe prova, çmon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar *cash* vlerën e apartamentit në shumën 104,000 euro, e cila më pas është arkëtuar pjesë-pjesë nga shoqëria “H” sh.p.k. në llogaritë e saj bankare në BKT dhe “Credins Bank”, për rrjedhojë, shuma 21,493.55 euro nuk përbën një shumë të paguar mbi vlerën e apartamentit.

Në përfundim të kësaj analize, Komisioni vendosi që në analizën financiare të vitit 2012 të mos përfshijë shumën 21,493.55 euro, përtej vlerës prej 104,000 eurosh të paguar për apartamentin. Rezultati final i analizës së vitit 2012 është trajtuar në pikën 31.4 të këtij vendimi.

25.19. Komisioni vlerëson të ndalet edhe tek kallëzimi penal i bërë nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me falsifikimin e firmës të bashkëshortit në dokumentin bankar. Në këtë kallëzim penal subjekti ka kërkuar procedimin penal për veprën penale të falsifikimit dhe të shpërdorimit të detyrës. Në vlerësim të Komisionit, rezultatet e këtij procedimi nuk ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit, për sa kohë nga ana e saj është provuar që: (i) nuk është bashkëshorti që ka kryer depozitimin e shumës 21,493.55 euro; (ii) shoqëria “H” sh.p.k. ka konfirmuar se kjo shumë është depozituar nga ekonomisti i saj për të plotësuar vlerën 104,000 euro të paguar *cash* nga bashkëshorti; (iii) çmimi i paguar për apartamentin justifikon sipërfaqen e tij, si dhe (iv) subjekti nuk ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare.

Në këto kushte, hetimi dhe zbardhja e së vërtetës në lidhje me personin që ka vendosur emrin e bashkëshortit të subjektit në dokumentin bankar, nuk mund të ndikojë në procesin e rivlerësimit të subjektit. Kjo çështje do të jetë objekt i procedimit penal për të evidentuar personat përgjegjës për falsifikimin e firmës së bashkëshortit të subjektit dhe shpërdorimit të detyrës, për sa i përket depozitimit të shumës 21,493.55 me firmën e supozuar të bashkëshortit të subjektit.

Hetimi i Komisionit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

25.20. Subjekti i rivlerësimit, si burim për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën *Vetting*, por edhe në DVP/2012 ka deklaruar tërheqjen e shumës 3,000,000 lekë nga bashkëshorti i saj në depozitën e tij në “Raiffeisen Bank” dhe huamarrjet në shumat përkatëse 50,000 euro, 3,000,000 lekë dhe 1,200,000 lekë.

Komisioni ka kryer një hetim të plotë lidhur mbi burimet financiare që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, si më poshtë vijon:

i) Depozitë bankare në “Raiffeisen Bank”, datë 4.7.2012, në vlerën 3,000,000 lekë, në emër të bashkëshortit të subjektit

25.21. Nga nxjerrja e llogarisë²⁰ së bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”, rezulton se:

- Në datën 23.3.2005 ka krijuar depozitë me afat maturimi 1-vjeçar në shumën 350,000 lekë.
- Në datën 18.4.2006 ka depozituar në llogarinë depozitë nr. *** shumën 400,000 lekë, me afat maturimi 3-mujor.
- Në datën 18.7.2006 ka tërhequr shumën 401,764 lekë dhe në datë 26.7.2006 ka transferuar në llogari depozite me afat maturimi 3-mujor shumën 300,000 lekë.

25.22. Këtë depozitë, bashkëshorti i subjektit e ka furnizuar me fonde në mënyrë periodike dhe në datën 3.7.2012 gjendja ka qenë në shumën 3,014,483.65 lekë.

- Në datën 4.7.2012 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr shumën 3,000,000 lekë.

Tabela nr. 4 – analiza financiare në lidhje me mundësinë e krijimit të kësaj depozite

	Vitet 2002-2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011
Shtesa në depozita	350,000.00	350,000.00	350,000.00	507,400.00	469,400.00	544,940.00	440,883.00

	2002-2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Pasuria	100,000.00	553,536.66	309,500.23	401,986.53	480,316.84	653,613.20	484,278.51
Ndryshim likuiditeti	0.00	553,536.66	309,500.23	401,986.53	480,316.84	653,613.20	484,278.51
Detyrime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Pasuria neto	100,000.00	553,536.66	309,500.23	401,986.53	480,316.84	653,613.20	484,278.51
Të ardhura	1,106,433.21	1,518,396.73	1,345,622.01	1,681,946.12	1,716,171.84	1,873,150.83	2,106,216.23
Shpenzime	563,644.00	591,425.83	652,694.80	620,683.95	916,645.20	822,062.70	865,977.00
Mundësia për kursime	442,789.21	373,434.24	383,426.98	659,275.64	319,209.80	397,474.93	755,960.72

25.23. Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shtesat financiare në depozita ndër vite.

ii) Hua e marrë nga shtetasi P. G, në vlerën 50,000 euro

25.24. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting* në lidhje me këtë hua, ka deklaruar: “*Huaja e marrë nga shtetasi P.G me qëllimin e blerjes së apartamentit me nr. ***, z.k. ***, me sipërfaqe 87.3 m² dhe verandë me sipërfaqe 73.5 m², me adresë: rruga ‘F. P’, ish-K.P, Tiranë. Kontrata e huas me nr. ***, datë 4.7.2012. Vlera e huas: 50,000 euro, me afat 10 vjet. Nga huaja janë shlyer 20,000 euro. Burimi: kredia bankare me vlerë 20,000 Euro. Mbetur pa u shlyer nga huaja 30,000 euro*”.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020, e “Raiffeisen Bank”.

25.25. Për të vërtetuar huan e marrë nga shtetasi P.G, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin e mëposhtëm:

i. Kontratë huaje noteriale nr. ***, datë 4.7.2012, sipas së cilës shtetasi P.G i ka dhënë bashkëshortit të subjektit shumën 50,000 euro, për një afat deri në marrjen e një kredie apo edhe për një afat tjetër 10 vjet, me qëllim blerjen e apartamentit të banimit. Në përmbajtje të kontratës, huadhënësi shprehet se kjo shumë është e ardhur nga puna dhe kursimet disavjeçare.

ii. Ekstrakt historik të shoqërisë “G” sh.a.²¹, në të cilën shtetasi P.G rezulton aksioner me 100% të aksioneve, si dhe administrator i saj.

iii. Mandat bankar nga “Alpha Bank”, për tërheqje *cash* nga llogaria e shoqërisë “G” sh.a. në vlerën 5,300,000 lekë, kryer nga shtetasi P.G në datën 11.5.2012.

iv. Mandat bankar nga “Alpha Bank” për tërheqje *cash* nga llogaria e shoqërisë “G” sh.a. në vlerën 4,000,000 lekë, kryer nga shtetasi P.G në datën 5.4.2012.

v. Në pyetësin standard, subjekti ka depozituar kopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 3.10.2007, sipas së cilës rezulton se shtetasi P.G ka shitur pasurinë “pyll” me sip. 44,000 m², duke përfutur vlerën 1,900,000 euro, për të cilën palët deklarojnë se janë likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale nëpërmjet “Tirana Bank”.

vi. Për të provuar marrjen e shumës 1,900,000 euro nga shtetasi P.G, subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie të këtij shtetasi në “Tirana Bank”, nga ku rezulton se në datën 4.10.2007 i ka kaluar shuma 1,885,750 euro. Nga kjo shumë shtetasi P.G në tetor të vitit 2007 ka transferuar në favor të shtetasit R.T shumën 1,000,000 euro, ndërsa shumën e mbetur e ka tërhequr *cash*.

25.26. Në shpjegimet e tij në ILDKPKI²² në lidhje me këtë huamarrje, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se: *“P. G është një miku im nga Shkodra. Mundësitë e tij financiare janë nga kompania ‘G’ sh.a. (ose e njohur ndryshe G.O). Gjendja e detyrimit është sipas deklaratës në shumën 30,000 euro në datën 31.12.2014”*.

25.27. I pyetur nga ILDKPKI-ja²³ në lidhje me këtë huadhënie, si dhe në lidhje me bilancin e shoqërisë dhe shumës së dividendit të tërhequr prej tij ndër vite, huadhënësi P.G ka deklaruar: *“Marrëdhënia me z. B është një marrëdhënie shoqërore e miqësie prej shumë vitesh. Sa i përket mundësive të mia financiare lidhur me këtë huadhënie, sqaroj se kjo vlerë nuk është tërhequr nga llogaritë e shoqërisë ‘G’ sh.a., pasi në këtë shoqëri nuk kam tërhequr dividend, me qëllim rritjen e kapitalit të shoqërisë. Këtë vlerë të hollash e kam fituar gjatë viteve, pasi ushtroj prej vitit 1993 aktivitetin e shitblerjes së hidrokarbureve, të vërtetueshme nëpërmjet deklarimeve mujore e vjetore, si dhe shitblerjes së pronave personale të luajtshme e të paluajtshme, të regjistruara në emrin tim personal”*.

25.28. Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit dhe bashkëshortit të saj pranë ILDKPKI-së lidhur me burimin e fondeve të huadhënësit, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas, nuk përputhet me deklaratimet e shtetasit P.G pranë këtij institucioni. Lidhur me këtë mospërputhje, subjekti ka sqaruar²⁴: *“Bashkëshorti e ka mik shtetasin P.G dhe e njeh si biznesmen të suksesshëm dhe ortak të shoqërisë ‘G’ sh.a. Aktiviteti i tij në tregtinë e naftës ka filluar që në*

²¹ Shoqëri aksionere me objekt aktiviteti “import eksport me shumicë e pakicë të karburanteve, lubrifikanteve, artikujve industrialë etj.”.

²² Kërkesë nr. *** prot., datë 20.4.2021, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 23.4.2021.

²³ Në përgjigje të pyetësinorit standard, subjekti ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2017, të ILDKPKI-së, drejtuar shtetasit P. G dhe shkresën kthim përgjigjeje datë 4.7.2017.

²⁴ Shihni përgjigjen në pyetësinorin e datës 20.9.2021.

vitet 1990. Kur kemi dhënë shpjegimet në ILDKPKI kemi menduar se shuma e dhënë hua vjen nga të ardhurat që ai ka krijuar nga aktiviteti tregtar. Por burimi i saktë i shumës së marrë hua është ai i deklaruar nga shtetasi P.G”.

25.29. Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit, subjekti ka paraqitur mandatarkëtimin nr. ***, datë 5.10.2007 dhe mandatarkëtimin nr. ***, datë 9.10.2007, për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore pranë ASHK-së në lidhje me pasurinë e paluajtshme të shitur nga shtetasi P.G.

25.30. Për sa më sipër, bazuar në deklaratimet e huadhënësit dhe shpjegimeve të subjektit, analiza financiare për këtë huadhënie do të kryhet duke konsideruar të ardhurat e shtetasit P.G nga paga dhe shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

25.31. Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me aftësinë financiare të shtetasit P. G, për dhënien e huas. Nga hetimi i kryer ka rezultuar:

- a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2021, informon lidhur me të ardhurat nga paga të përfituara nga shtetasi P.G nga janari i vitit 2012 e në vijim. Ky institucion informon gjithashtu edhe mbi punësimet e këtij shtetasi në vitet 1984 - 1989, por nuk paraqiten të dhëna lidhur me të ardhurat e përfituara prej tij nga këto punësime.
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. ***, datë 21.6.2021, informon se shtetasi P. G rezulton administrator dhe aksioner i subjektit “G.O.G” sh.a, themeluar në datën 15.6.2007.
- c) Drejtoria e tatimpaguesve të mëdhenj²⁵ ka vënë në dispozicion bilancet vjetore të shoqërive tregtare të zotëruara nga shtetasi P. G.
- d) Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, informon se shtetasi P.G figuron administrator dhe aksioner zotërues i 82% të kapitalit në shoqërinë “G.O.G” sh.a.²⁶ me NIPT K***E.

Gjithashtu, informon se ky shtetas rezulton të ketë qenë administrator dhe ortak zotërues i 100% të kapitalit në shoqërinë “G. C. GKJ” sh.p.k. me NIPT K***T dhe është larguar në datën 2.2.2012.

Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “G” sh.a. rezulton se në datën 22.7.2011 shoqëria ka zmadhuar kapitalin e saj, duke e kaluar në vlerën 107,000,000 lekë.

Në seksionin “shënime të përgjithshme” të pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2011 sqarohet se zmadhimi i kapitalit në vitin 2011 është kryer përmes fitimeve të paspërndara të viteve të mëparshme dhe ka arritur në shumën 107,000,000 lekë në bazë të vendimit të asamblesë së aksionerit të vetëm P.G.

- e) ASHK-ja informon se shtetasi P.G ka në pronësi në qytetin e Shkodrës pasuri të paluajtshme, të cilat rezultojnë të jenë krijuar përpara shitjes së truallit dhe dhënies së huas, si dhe pasuri të krijuara pas dhënies së huas. Për pasojë, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare, por do të përfshihet vetëm investimi i kryer në vitin 2007 për ndërtimin e objektit “pikë karburanti”, trajtuar në vijim.

Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja ka rezultuar se shtetasi P.G ka në pronësi pasurinë e llojit “arë + truall”, me nr. **, z. k. ***, e regjistruar me certifikatë pronësie datë

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, drejtuar DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.11.2021, e drejtorisë së tatimpaguesve të mëdhenj; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.12.2021, e DRT-së Shkodër.

²⁶ Kjo shoqëri ka ndryshuar emërtimin nga “G” sh.a. në “G.O.G” sh.a.

3.12.2002. Mbi këtë pasuri rezulton të jetë ndërtuar objekti “pikë karburanti dhe ambiente shërbimi”, miratuar me lejen e ndërtimit nr. *, datë 14.12.2006.

Sipas procesverbalit të aktit të kolaudimit të ndërtimit datë 22.12.2007, nënshkruar nga investitori P.G, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, shuma totale e punimeve të kryera mbi bazën e kësaj lejeje ndërtimit, sipas situacionit përfundimtar, është 12,677,755 lekë.

25.32. Për të vërtetuar të ardhurat e përfituara nga huadhënësi P.G përmes shitjes së pasurisë “pyll” me sip. 44,000 m², Komisioni ka administruar:

- a. kopje të plotë të dokumentacionit tekniko-ligjor²⁷ të pasurisë “pyll”, me nr. pasurie ***, pjesë e së cilit është edhe kontrata e shitjes nr. ***, datë 3.10.2007, përmes së cilës shtetasi P.G ka tjetërsuar pronësinë e kësaj pasurie në favor të shoqërisë “Xh” sh.p.k. Bashkëlidhur kontratës gjendet kopje e mandatarkëtimeve nr.*** dhe nr. ***, datë 5.10.2007, përmes së cilëve shtetasi P.G ka arkëtuar pranë ASHK-së pagesën e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë në shumën totale 4,784,200 lekë;
- b. llogaritë bankare të shtetasit P.G.

Tabela nr. 5 – analiza financiare

	Kumulative 2007 – 4.7.2012
Pasuri	-2,007,045.01
<i>Ndryshim likuiditeti (shitesa/pakësime)</i>	<i>-2,007,045.01</i>
Të ardhura	230,492,097.50
Të ardhura nga puna	2,486,065.00
Të ardhura nga shitja e pasurive	228,006,032.50
Shpenzime	131,764,357.33
Shpenzime jetike	752,874.00
Shpenzime për ndërtim pikë karburanti, Shkodër	2,817,283.33
Shpenzim për “G” (G.O.G), datë 15.6.2007	2,500,000.00
Shpenzim për tatimin e kalimit të pronësisë	4,784,200.00
Hua dhënë z. R.T	120,910,000.00
Mundësi për kursime	100,734,785.18

25.33. Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, në analizë financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e shtetasit P.G nga shitja e pasurisë “pyll” me sip. 44,000 m² në vlerën 1,900,000 euro;
- të ardhurat nga paga deri në datën e dhënies së huas ndaj bashkëshortit të subjektit;
- të ardhurat nga paga deri në datën e dhënies së huas ndaj bashkëshortit të subjektit;
- shpenzimet për pagesën e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë “pyll” me sip. 44,000 m², në vlerën 4,784,200 lekë, sipas mandatarkëtimeve datë 5.10.2007;
- shpenzimet e kryera nga huadhënësi në formën e investimit për ndërtimin e objektit “pikë karburanti dhe ambiente shërbimi”, miratuar me lejen e ndërtimit nr. *, datë 14.12.2006, në vlerën 12,677,755 lekë. Periudha e ndërtimit është 9 muaj, ndërsa në analizë janë konsideruar shpenzimet e dy muajve të fundit në vlerën 2,817,283.33 lekë;
- shpenzimet e kryera nga huadhënësi në formën e investimit në kapitalin e shoqërisë “G” sh.p.k. nga aksioneri i vetëm P.G në vlerën 2,500,000 lekë;

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, drejtuar ASHK-së Shkodër; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.10.2021, e ASHK-së Shkodër.

- shpenzimet jetike janë llogaritur për një person;
- huaja dhënë në favor të shtetasit R.T në shumën 1,000,000 euro;
- metodologjia e përdorur është ajo kumulative, pasi huadhënësi nuk është subjekt i deklaramit periodik të pasurisë;
- Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare investimet e kryera nga shtetasi P.G përpara datës 5.10.2007 dhe pas datës 4.7.2012.

25.34. Nga analiza financiare rezulton se huadhënësi P.G ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 50,000 euro.

Në vlerësimin përfundimtar të çështjes në lidhje me mundësinë e shtetasit P.G për t'i dhënë hua bashkëshortit të subjektit, Komisioni i është referuar:

- i. Vendimit nr. 20/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: *“[...] për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur [...]”*.
- ii. Vendimit nr. 15/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: *“[...] në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”*.

Bazuar në referimet e mësipërme, Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar pasurinë e shtetasit P. G vetëm në kufijtë e huas së dhënë, duke analizuar vetëm të ardhurat e tij që kanë shërbyer si burim për krijimin e saj. Gjithashtu, Komisioni mban në vëmendje se nuk janë llogaritur të ardhurat e tjera të krijuara nga familja e z. G, për sa kohë nuk kanë shërbyer si burime për krijimin e huas.

25.35. Komisioni ka kryer hetim edhe në lidhje me shlyerjen e huas ndaj huadhënësit P.G. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar se ka marrë kredi bankare në “Raiffeisen Bank” me vlerë 20,000 euro, për të shlyer një pjesë të detyrimit ndaj shtetasit P. G. Mbetur pa u shlyer nga kredia vlera 17.515,57 euro.

25.36. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me bashkëshortin e saj, në datën 19.10.2012 kanë nënshkruar kontratën e kredisë bankare dhe hipotekës nr. ***, për vlerën 20,000 euro, me afat 240 muaj, me qëllim financimi “blerje shtëpie”. Sipas nenit 1 të kësaj kontrate një pjesë e fondeve do të transferohen në llogari të shoqërisë “S” sh.a. për pagesën e primit të sigurimit²⁸, ndërsa pjesa tjetër do të transferohen në llogari të huadhënësit P.G sipas deklaratës së huas nr.

²⁸ Sipas policës së sigurimit të jetës nga “S” sh.a., vlera e primit të sigurimit rezulton të jetë 57.14 euro.

***, datë 4.7.2012. Si garanci²⁹ për këtë kredi është vendosur apartamenti i blerë nga subjekti dhe bashkëshorti, me nr. pasurie ***.

25.37. Nga nxjerrja e llogarisë në euro në “Raiffeisen Bank” të bashkëshortit të subjektit, rezulton se në datën 2.11.2012 është disbursuar huaja në shumën 20,000 euro. Këtë shumë bashkëshorti i subjektit, në datën 5.11.2012 e ka transferuar në llogarinë e shtetasit P.G, me emërtim “kthim borxhi sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 4.7.2012”. “Raiffeisen Bank” informon se detyrimi i pashlyer i kredisë deri në datën 28.1.2020 është në vlerën 15,251.07 euro.

25.38. Referuar shkresës kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 7.2.2020, të “Credins Bank”, nga nxjerrja e llogarive rezulton se në datën 19.12.2019 subjekti ka tërhequr nga llogaria e saj shumën 2,000,000 lekë.

25.39. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësonin standard, ka depozituar mandatarëkëtimin datë 27.12.2019, nga “OTP Bank”, nëpërmjet së cilit bashkëshorti i saj ka depozituar shumën 17,000 euro në llogarinë e shtetasit P.G, si dhe një letër me kursin e këmbimit me vulë të shoqërisë “A&L” sh.p.k., ku rezulton se shuma 2,000,000 lekë është këmbyer me 16,461 euro.

25.40. Bazuar në shkresën nr. ***, datë 11.6.2021, të “OTP Bank”, nga nxjerrja e llogarisë së shtetasit P.G rezulton se në datën 27.12.2019 bashkëshorti i subjektit ka depozituar në llogarinë e këtij shtetasi shumën 17,000 euro dhe në datën 28.5.2021 ka depozituar në llogarinë e tij shumën 13,000 euro.

25.41. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kthimin pjesor të huas në vlerën 17,000 euro në datën 27.12.2019, ndërsa në lidhje me kthimin e vlerës 13,000 euro në datën 28.5.2021 Komisioni nuk ka mundur të kryejë një analizë, pasi nuk është kryer ende deklarimi periodik për vitin 2021.

iii) Hua e marrë nga shtetasi I.H, në vlerën 3,000,000 lekë

25.42. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting* në lidhje me këtë hua, ka deklaruar: “*Hua e marrë nga shtetasi I. Q.H, i datëlindjes 18.4.1951, në vlerën 3,000,000 lekë. Kjo hua është shlyer e tëra në vlerën e saj, pa interesa sipas marrëveshjes, ku si burim janë shfrytëzuar të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit, si dhe vlera prej 10,000 euro dhuruar nga nëna N.B*”.

25.43. Për të vërtetuar huan e marrë nga shtetasi I.H dhe aftësinë financiare të tij për dhënien e kësaj huaje, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin e mëposhtëm:

i. Deklaratë e shtetasit I.H për dhënie huaje (shkresë e thjeshtë), datë 1.7.2012, përmes së cilës deklaroi se në këtë datë i ka dhënë shtetasit S.B shumën 3,000,000 lekë për blerjen e një shtëpie banimi. Ai deklaroi se huamarrësi duhet t’ia kthejë këtë shumë për një afat prej 15 vitesh, sipas mundësisë së tij.

ii. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.10.2012, nënshkruar nga shtetasit S.B dhe I.H, ku bashkëshorti i subjektit deklaroi se ka marrë hua shumën 3,000,000 lekë nga z. H në datën 1.7.2012, të cilën do t’ia kthejë me këste pas 15 vjetësh deri në datën 1.7.2027.

iii. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.12.2016, nënshkruar nga shtetasit I.H dhe S.B, sipas së cilës shtetasi I.H deklaroi se në datën 1.7.2012 i ka dhënë shtetasit S.B shumën hua prej

²⁹ Vërtetim nga regjistri i inskriptimeve, datë 24.10.2012

3,000,000 lekësh për blerje banese, pa interes, me afat 15 vjet. Sipas deklaruesit I.H, në datën 1.7.2012 ka lëshuar edhe një deklaratë dore për huadhënien e kësaj shume. Në përmbajtje të deklaratës noteriale, shtetasi I.H deklaroi se:

- në datën 22.3.2013 z. B i ka dhënë shumën 1,500,000 lekë si këst për shlyerjen e shumës së dhënë hua;
- në datën 20.12.2014 i ka dhënë shumën 600,000 lekë;
- në datën 20.12.2015 i ka dhënë shumën 500,000 lekë;
- ndërsa në datën 3.11.2016 i ka dhënë shumën 400,000 lekë përmes transfertës nga llogaria e E. B në “Tirana Bank”.

Në këto data shtetasi I.H deklaroi se ka lëshuar deklaratë dore për shlyerjen e këtyre shumave.

iv. Mandatpagesë datë 3.11.2016, sipas të cilit subjekti ka transferuar shumën 400,000 lekë në llogarinë e shtetasit I.H në “Tirana Bank”, me emërtimin “shlyerje pjesore e borxhit për blerjen e apartamentit”. Ky transferim konfirmohet edhe nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank”.

v. Deklaratë e shtetasit I.H (shkresë e thjeshtë), datë 20.12.2015, ku deklaroi se bashkëshorti i subjektit i ka paguar shumën 500,000 lekë si këst për shlyerjen e huas prej 3,000,000 lekësh.

vi. Deklaratë e shtetasit I.H (shkresë e thjeshtë), datë 20.12.2014, ku deklaroi se bashkëshorti i subjektit i ka paguar shumën 600,000 lekë si këst për shlyerjen e huas prej 3,000,000 lekë.

vii. Deklaratë e shtetasit I.H (shkresë e thjeshtë), datë 22.3.2013, ku deklaroi se bashkëshorti i subjektit i ka paguar shumën 1,500,000 lekë si këst për shlyerjen e huas prej 3,000,000 lekësh.

25.44. Për të vërtetuar të ardhurat e shtetasit I.H, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*, pyetësorit standard dhe pyetësorit datë 20.9.2021, dokumentet si vijon:

- a) Vërtetim nr. *** prot., datë 17.4.2018, nga ISSH-ja, mbi të ardhurat e shtetasit I.H.
- b) Vërtetim datë 22.1.2020, nga punëdhënësi Qendra Shëndetësore Spitalore nr. *, mbi të ardhurat e shtetasit D.H (bashkëshortja e huadhënësit I.H).
- c) Vërtetim nr. ** prot., datë 21.1.2020, nga punëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, mbi të ardhurat e shtetasit A.H (djali i huadhënësit I.H).
- d) Nxjerrje llogarie bankare nr. ***, të shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k. në “Tirana Bank”, nga ku rezultojnë tërheqje me çek nga shtetasi I.H, si vijon: gjatë vitit 2010 janë kryer tre tërheqje me çek, në total 560,000 lekë; gjatë vitit 2011 janë kryer tre tërheqje me çek, në total 3,609,000 lekë; gjatë vitit 2012 janë kryer tre tërheqje me çek deri në datën 1.7.2012, në total 2,370,000 lekë.
- e) *Statement* të llogarisë bankare të “I.H”, person fizik, në “Tirana Bank”, për periudhën 2013 – 2016, nga ku evidentohen të ardhura si person fizik të shtetasit I.H, por që nuk mund të përfshihen në analizë financiare pasi janë krijuar pas dhënie së huas.
- f) Certifikatë regjistrimi të personit fizik “I.H”, me NIPT L***C.
- g) Ekstrakt historik nga regjistri tregtar i QKB-së, nga i cili rezulton se subjekti “I.H” person fizik, është regjistruar në QKB në datën 18.4.2013, me fushë veprimtarie të aktivitetit “servis makinash”.
- h) Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.1.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas së cilës nga verifikimi i të dhënave në sistem C@TS rezulton se subjekti “K.D.K.” sh.p.k. ka operuar me adresë sekondare ish-SMT-ja Vorë, me nr. serial ***, nga data 13.9.2010 deri më 7.6.2013.
- i) Aktmarrëveshje nr. ***, datë 30.4.2009, mes shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k. dhe shtetasit I. H, sipas së cilës kjo shoqëri vendos në dispozicion të këtij shtetasi një sipërfaqe trualli prej 2,000 m² dhe një ndërtesë në formë kapanoni me vendndodhje në Tiranë, gjendja e së cilës

është e amortizuar dhe e rrënuar. Z. H pranon të marrë këtë pronë, me qëllim që ta përmirësojë nëpërmjet investimit dhe ta kthejë në një ambient ku mund të zhvillojë aktivitet tregtar si servis makinash etj.

Referuar aktmarrëveshjes së mësipërme, shtetasi I.H do të punonte fillimisht me NIPT sekondar të shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k. Vlera e investimit e llogaritur nga palët ishte në shumën 250,000 euro.

Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k. rezulton se në datën 13.9.2010 shoqëria ka hapur NIPT sekondar me adresë në V, si dhe ka shtuar objektin e aktivitetit të shoqërisë për “punime në fushën e ndërtimit dhe hapje pikë servisi për riparimin e mjeteve motorike”, NIPT i cili është mbyllur në datën 7.6.2013. Mbyllja e NIPT-it korrespondon me hapjen e NIPT-it nga shtetasi I.H në datë 18.4.2013, me objekt veprimtarie “servis makinash”.

- j) Deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.1.2020 (deklaratë e cila rezulton të jetë hartuar gati dy vjet përpara dërgimit të pyetësorit subjektiv të rivlerësimit), nënshkruar nga deklaruesit Dh. T dhe I.H. Sipas kësaj deklarate z. T, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k., deklaroi se shoqëria ka vënë në dispozicion të z. H një sipërfaqe toke me sip. 2,000 m² dhe një kabanon që ndodhet në V, Tiranë, për të investuar dhe për të krijuar një ambient të përshtatshëm për servis makinash me vlerë 250,000 euro. Prona i është dorëzuar në vitin 2009 z. H, i cili ka kryer investimin. Ky shtetas ka punuar me NIPT sekondar të shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k. Në kuadër të marrëveshjes shoqëria i ka kthyer një pjesë të investimit nëpërmjet pagesave me çek.
- k) Vendim, datë 5.1.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e personit juridik të shoqërisë “A” sh.p.k. me ortak të vetëm dhe administrator z. I.H, me kapital fillestar 110,000 lekë.
- l) Vendim, datë 1.10.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e personit juridik të shoqërisë “A” sh.p.k., me ortak të vetëm dhe administrator z. I.H, me kapital fillestar 1,000 USD.

25.45. Pas analizimit të dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se:

a) Shtetasi I.H ka pasur një marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë “K.D.K.” sh.p.k., sipas së cilës kjo shoqëri në datën 30.4.2009 ka hapur NIPT sekondar me vendndodhje në V (adresa i përket vendit të zhvillimit të aktivitetit të z. H).

Ky NIPT është mbyllur në datën 7.6.2013. Mbyllja e NIPT-it sekondar të shoqërisë korrespondon me hapjen e NIPT-it si “person fizik” nga z. I.H në datën 18.4.2013. Nga lëvizjet e llogarive bankare të shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k. rezulton se ka pasur depozitime periodike (duke u cituar dhe faturat përkatëse) nga shoqëri sigurimi për pagesë për likuidim dëmi. Këto depozitime rezultojnë të tërhequra me çek nga shtetasi I.H, i cili për periudhën 2010 – 2012 ka tërhequr shumën totale prej 6,539,000.00 lekësh. Subjekti, së bashku me pyetësorin e datës 20.9.2021, ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2021, të DRT-së Tiranë, sipas së cilës provohet se shoqëria “K.D.K.” sh.p.k. ka paguar të gjitha detyrimet tatimore për vitin 2012.

Për sa më sipër, të ardhurat e përfituara nga shtetasi I.H përmes tërheqjeve të kryera me çek nga llogaria e shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k. do të konsiderohen të ligjshme, për sa kohë detyrimet tatimore janë paguar nga kjo shoqëri.

b) Huaja e dhënë nga shtetasi I.H në favor të bashkëshortit të subjektivit daton më 1.7.2012, ndërkohë që aktiviteti privat “servis makinash” i huadhënësit I.H ka filluar në datën 18.4.2013.

Në këto kushte, të ardhurat e përfituara nga huadhënësi nga ky aktivitet tregtar nuk mund të kenë shërbyer për huan e dhënë në favor të bashkëshortit të subjektit dhe nuk do të merren në konsideratë në analizën financiare.

c) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të regjistrimit të shoqërive “A” sh.p.k. dhe “A” sh.p.k., rezulton se shoqëria “A” sh.p.k. ka kaluar në status pasiv në vitin 2003, ndërsa shoqëria “A” sh.p.k. nuk rezulton e identifikuar me NIPT pranë DPT-së.

Në këto kushte, si dhe në mungesë të dokumentimit të të ardhurave të përfituara nga shtetasi I.H nga këto aktivitete tregtare, nuk evidentohen të ardhura të ligjshme, të cilat mund të kenë shërbyer për dhënien e huas nga ky shtetas në favor të subjektit të rivlerësimit.

25.46. Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me aftësinë financiare të shtetasit I. H për dhënien e huas.

Nga hetimi i kryer ka rezultuar:

i. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2021, informon lidhur me të ardhurat nga paga të përfituara nga shtetasi I.H nga qershori i vitit 2012 e në vijim.

ii. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2021, informon se shtetasi I.H rezulton administrator i subjektit “I.H”, person fizik, me NIPT L***C, themeluar në datën 18.4.2013, pra pas datës së huadhënies.

iii. Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, informon se shtetasi I.H figuron i regjistruar si person fizik, pajisur me NIPT L***C, si dhe administrator dhe ortak zotërues i 100% të kapitalit në shoqërinë “A” sh.p.k. me NIPT J***S.

iv. ASHK-ja³⁰ informon se shtetasi I.H ka në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij pasurinë apartament me sip. 75 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në rrugën “K.L”, Tiranë, përfituar përmes kontratës së shitjes datë 3.8.1993, lidhur me Ndërmarrjes Komonale Banesa Tiranë, me vlerë totale 29,436 lekë.

Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, në analizë financiare janë përfshirë:

- të ardhura nga punësimi i huadhënësit (ISSH-ja ka pasqyruar vetëm pagat bruto. Komisioni ka përlllogaritur pagën neto duke iu referuar legjislacionit tatimor të publikuar nga Ministria e Financave për vitet përkatëse);
- të ardhura nga punësimi i bashkëshortes dhe djalit të huadhënësit;
- të ardhurat e përfituara sipas tërheqjeve me çeqe bankare nga llogaria e shoqërisë “K.D.K.” sh.p.k.;
- shpenzimet jetike janë llogaritur për 3 persona;
- metodologjia e përdorur është ajo kumulative, pasi huadhënësi nuk është subjekt i deklaramit periodik të pasurisë;
- Komisioni, në lidhje me mundësinë e shtetasit I.H për t’i dhënë hua bashkëshortit të subjektit, i është referuar vendimeve nr. 20/2019 dhe nr. 15/2019 të Kolegjit, duke analizuar dhe vlerësuar pasurinë e shtetasit I. H vetëm në kufijtë e huas së dhënë, pasi referuar praktikës së konsoliduar të Kolegjit objekti i hetimit të Komisionit është vetëm vërtetimi i burimit të ligjshëm të të ardhurave për dhënien e huas.

Tabela nr. 6

	Viti 2010	Viti 2011	Datë 1.7.2012	Kumulative 2010 – 1.7.2012

³⁰ Aplikim në portalin elektronik të ASHK-së, nr. ***, datë 7.7.2021; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.10.2021, e ASHK-së.

Pasuri	(4,529.79)	29,666.46	(24,814.55)	322.12
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>(4,529.79)</i>	<i>29,666.46</i>	<i>(24,814.55)</i>	<i>322.12</i>
Të ardhura	1,287,299.00	4,912,740.00	3,102,001.96	9,302,040.96
Të ardhura nga paga I. H, Ministria e Tregtisë e Turizmit	0.00	0.00	0.00	0.00
Të ardhura nga paga I. H, "A" sh.p.k.	0.00	0.00	0.00	0.00
Të ardhura nga paga I.H "K.D.K." sh.p.k.		284,240.00	180,880.00	465,120.00
Të ardhura nga paga D.H	326,856.00	381,374.00	230,473.83	938,703.83
Të ardhura nga paga A.H	400,443.00	638,126.00	320,648.13	1,359,217.13
Tërheqje me çek <i>payment</i> nga llogaria e "K.D.K." sh.p.k.	560,000.00	3,609,000.00	2,370,000.00	6,539,000.00
Shpenzime	409,860.00	409,860.00	209,322.00	1,029,042.00
Shpenzime jetike	409,860.00	409,860.00	209,322.00	1,029,042.00
<i>Mundësi për kursime</i>	<i>881,968.79</i>	<i>4,473,213.54</i>	<i>2,917,494.51</i>	<i>8,272,676.84</i>
Mundësi për kursime kumulative	881,968.79	5,355,182.33	8,272,676.84	

25.47. Nga analiza financiare rezultoi se huadhënësi I.H ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 3,000,000 lekë.

25.48. Komisioni ka kryer hetim edhe në lidhje me shlyerjen e huas ndaj huadhënësit I.H. Lidhur me shlyerjen e kësaj huaje, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: "Kjo hua është shlyer në vlerën e saj, ndër vite, ku si burim janë shfrytëzuar të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortit, si dhe shuma prej 10,000 euro që nëna ime më ka dhuruar".

25.49. Nga verifikimi i DVP-ve vjetore, shlyerja e huas ndaj shtetasit I.H rezulton e deklaruar si vijon:

- në DVP/2013 subjekti deklaroi shlyerjen e vlerës 1,500,000 lekë ndaj shtetasit I.H, sipas shkresës së thjeshtë, datë 22.3.2013;
- në DVP/2014 subjekti deklaroi shlyerjen e vlerës 600,000 lekë;
- në DVP/2015 subjekti deklaroi shlyerjen e vlerës 500,000 lekë;
- në DVP/2016 subjekti deklaroi shlyerjen e vlerës 400,000 lekë.

Tabela nr. 7 – analiza financiare për mundësinë e shlyerjes së huas ndaj shtetasit I.H

	Mars 2013	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016
PASURIA	13,391.34	183,995.31	-13,992.15	86,430.92
Automjeti tip "Peugeot **"		170,000.00		
Ndryshim likuiditeti	13,391.34	13,995.31	-13,992.15	86,430.92
DETYRIME	-1,561,485.24	-841,548.24	-734,190.83	-725,934.72
Pagesë e huas nga I. H	-1,500,000.00	-600,000.00	-500,000.00	-400,000.00
Pagesë e huas nga S.A				-100,000.00
Pagesa të kredisë bankare	-61,485.24	-241,548.24	-234,190.83	-225,934.72
PASURIA NETO	1,574,876.58	1,025,543.55	720,198.68	812,365.64
TË ARDHURA	482,281.25	2,277,116.00	2,251,404.00	2,632,615.00
Të ardhurat e subjektit	194,084.75	1,122,723.00	1,079,958.00	1,102,941.00
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit S. B	288,196.50	1,154,393.00	1,171,446.00	1,529,674.00

SHPENZIME	141,024.00	1,196,711.90	1,296,771.71	1,238,620.40
Shpenzime jetike	141,024.00	879,992.00	897,104.00	940,368.00
TIMS		152,719.90	240,542.71	151,502.40
Shpenzime shkollimi H.B, shkolla "P"		164,000.00	159,125.00	146,750.00
Mundësia për kursime	-1,233,619.33	54,860.55	234,433.61	581,628.96

25.50. Në analizën financiare nuk është përshirë shuma 10,000 euro e dhuruar nga nëna e subjektit, e trajtuar në vijim.

25.51. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën Vetting, ka deklaruar se nëna e saj i ka dhuruar shumën 10,000 euro, me qëllim mbulimin e vlerës së blerjes së shtëpisë.

25.52. Në datën 6.9.2012, me deklaratën noteriale nr. ***, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. N.B, deklaroi se i ka dhuruar subjektit shumën 10,000 euro. Sipas përmbajtjes së kësaj deklaratë nëna e subjektit deklaroi se ka në pronësi të saj shumën 10,000 euro dhe me vullnetin e saj të lirë ia dhuron vajzës së saj Elfrida Bregova, si dhuratë për shtëpinë e re.

25.53. Subjekti, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasës N.B, ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentin me emërtim "shënim informues i tatimit mbi të ardhurat e personit fizik me bazë deklarimi fillestar" për periudhën 2002 – 2014, të shtetasit Th.B (babai i subjektit), në të cilat pasqyrohen të ardhurat e përfituara prej tij dhe bashkëshortes në shtetin grek.

Bazuar në këto dokumente rezulton se babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit kanë pasur të ardhura vjetore, të paraqitura në tabelën vijuese:

Tabela nr. 8

EURO	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	6.9.2012
Të ardhurat e babait		8,577.68	8,972.07	10,669.18	7,428.68	5,797.54	12,132.75	6,691.58	3,904.43	10,957.66	4,538.09
Të ardhurat e nënës	1,046.01	4,180.96	8,272.17	9,353.19	10,514.33	11,430.00	12,621.41	12,968.47	13,578.35	11,694.40	8,641.91
Totali i të ardhurave	1,046.01	12,758.64	17,244.24	20,022.37	17,943.01	17,227.54	24,754.16	19,660.05	17,482.78	22,652.06	13,180.00

25.54. Në lidhje me dhurimin e kësaj shume, subjekti i rivlerësimit, bazuar në procesverbalin e datës 26.1.2016, përpara ILDKPKI-së³¹ ka deklaruar se: "Ky transaksion është kryer cash, kur na ka lindur djali nëna e ka dërguar shumën në dy pjesë, shuma 5,000 euro nëpërmjet motrës time A.B, e cila ka ardhur nga Greqia dhe pjesa tjetër është sjellë nga nëna ime e cila bëri edhe kontratën e dhurimit".

Për të vërtetuar hyrjen e shtetasës A.B në shtetin shqiptar, subjekti ka paraqitur kopje të fletës së printuar nga sistemi TIMS lidhur me hyrjet dhe daljet në/nga territori shqiptar, sipas të cilës rezulton se kjo shtetase ka hyrë në Shqipëri në datën 3.8.2012.

25.55. Për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve gjatë hetimit administrativ³², subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat e shtetasve Th.B dhe N.B, ka vënë në dispozicion dokumentacionin si më poshtë vijon:

- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.9.2012, të hartuar pranë noteres D. K;
- dokument identifikimi të shtetit grek për shtetasit Th.B dhe N.B;

³¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2020, nga ILDKPKI-ja.

³² Shihni përgjigjet e pyetësorit standard.

- c. dokumentacion nga shteti grek mbi të ardhurat e personit të tatuar Th.B, me emërtim “njoftim i likuidimit të tatimit mbi të ardhurat e personit fizik me bazë deklarinin fillestar internet” për vitet 2003 - 2013.

25.56. Analizë financiare mbi mundësinë e dhurimit të shumës 10,000 euro nga nëna e subjektit N.B

Metodologjia e përdorur është ajo kumulative, pasi nëna e subjektit nuk është subjekt i deklarinimit periodik të pasurisë.

- Viti i fillimit të analizës është viti 2002, për të cilin është paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat e shtetasve Th dhe N.B.
- Analiza vazhdon deri më 6.9.2012, datë e cila përkon me hartimin e deklaratës noteriale për huadhënie nga shtetasja N.B.
- Lidhur me kurset e këmbimit nga euro në lekë, janë përdorur kurset mesatare të marra nga Banka e Shqipërisë për vitet përkatëse.
- Janë llogaritur shpenzimet e jetesës, të cilat janë marrë në bazë të përbërjes familjare sipas të dhënave përkatëse për Greqinë³³.

Tabela nr. 9.

Dhurimi i shumës 10,000 euro	Totali kumulativ 2004 – 6.9.2012
<i>Të ardhura në euro</i>	<i>170,166.21 €</i>
Të ardhurat e babait	71,091.98 €
Të ardhurat e nënës	99,074.23€
<i>Shpenzime në euro</i>	<i>108,826.00 €</i>
Shpenzime jetike (2 persona)	108,826.00 €
Mundësi për kursime	61,340.21 €

25.57. Nga analiza financiare e prindërve të subjektit rezulton se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e shumës prej 10,000 euro.

25.58. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me shumën e dhuruar nga nëna e saj, në deklaratën *Vetting*, por edhe gjatë hetimit, ka deklaruar se ka shërbyer për shlyerjen pjesore të huas dhënë nga shtetasi I.H. Në lidhje me këtë deklarinim të subjektit, nga hetimi ka rezultuar se:

i) Në deklarinim periodik të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurimin e shumës 10,000 euro nga nëna e saj, përmes deklaratës noteriale nr. ***, datë 6.9.2012. Në këtë deklarinim subjekti nuk ka deklaruar shtesë pasurie në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”.

ii) Në deklarinim periodik të vitit 2013, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, por ka deklaruar shlyerjen e vlerës 1,500,000 lekë në favor të huadhënësit I.H.

25.59. Lidhur me konstatimet e mësipërme, në përgjigje të pyetësorit datë 20.9.2021, subjekti ka sqaruar se: “*Kjo shumë nuk është deklaruar si shtesë cash në DVP, pasi duke qenë se e kemi deklaruar në rubrikën ‘dhurata dhe trajtime preferenciale’, në pakujdesi nuk e kemi deklaruar gjendje cash, duke menduar se rezultonte e deklaruar në rubrikën e dhuratave. Në vitin pasardhës, duke qenë se nuk e kishin deklaruar shtesë në cash, rrjedhimisht nuk mund ta deklaranim pakësim. Në DVP/2013 nuk kemi deklaruar se kjo shumë ka shërbyer si burim për shlyerjen pjesore të huas së z. I. H, pasi deklarata në formatin e saj nuk parashikon rubrikë*

³³ Sipas të dhënave të shërbimit statistikor grek <https://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>

për burimin e krijimit për shlyerjen e huas, por parashikon gjendjen e detyrimit të shlyer dhe gjendjen e detyrimit të mbetur pa shlyer”.

25.60. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerësoi të mos e konsiderojë shumë 10,000 euro si burim për shlyerjen e huas ndaj shtetasit I.H në vitin 2013, pasi nga ana e subjektit nuk rezulton që kjo shumë të jetë deklaruar si shtesë dhe më pas si pakësim në deklaratat periodike vjetore. Për rrjedhojë, rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e detyrimit prej 1,500,000 lekësh në mars të vitit 2013 ndaj huadhënësit I. H. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë konstatim.

25.61. Në parashtrimet e saj, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se: *“Në momentin e plotësimit të deklaratës periodike të pasurisë të vitit 2012, të cilën e kam plotësuar në datën 28.3.2013, i kisha kthyer z. H shumë prej 1,500,000 lekësh në datën 22.3.2013. Në këto kushte, kam menduar që, për sa kohë unë këtë shumë nuk e kisha në gjendje, nuk kisha arsye ta deklaroj. Për rrjedhojë të mosdeklarimit të shtimit në deklarin e vitit 2012 nuk kam deklaruar as pakësimin në vitin 2013. Unë pranoj që nuk kam kryer deklarin të saktë në deklaratat periodike në lidhje me shumë 10,000 euro, pavarësisht se e kam deklaruar dhuratë nga mamaja, por këtë pasaktësi unë e kam rregulluar në vitin 2016, ku kam deklaruar se si burim për kthimin e huas z. I.H ka shërbyer shuma prej 10,000 euro. Unë kam qenë e saktë në deklaratën Vetting, pasi kam deklaruar se shuma 10,000 euro ka shërbyer si burim për kthimin e pjesshëm të huas z. I. H, si dhe kam qenë e saktë edhe gjatë hetimit administrativ, ku i kam qëndruar deklarimeve të mia si në deklaratën Vetting”.*

25.62. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, konstaton se:

- i. Bazuar në procesverbalin datë 25.3.2016, të ILDKPKI-së³⁴, rezulton se subjekti, së bashku me bashkëshortin, në përgjigje të pyetjes nr. 4, kanë deklaruar se burimi i të ardhurave të përdorura për shlyerjen e pjesshme të huas shtetasit I.H ka qenë shuma 10,000 euro, e dhuruar nga nëna e subjektit.

Komisioni vëren se procesverbali i datës 25.3.2016 është hartuar në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. ***, i cili parashikon se: *“Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarinet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit”.* Në këto kushte, ky procesverbal i hartuar, mbështetur mbi një dispozitë ligjore nga organi kompetent, vlerësohet se është një dokument zyrtar, në kuptim të nenit 49, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, i cili për më tepër është administruar nga Komisioni zyrtarisht prej institucionit që e ka hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit.

- ii. Në seksionin e të dhënave konfidenciale të deklaratës Vetting subjekti ka deklaruar si burim për shlyerjen e pjesshme të huas së shtetasit I. H shumë prej 10,000 euro, dhuruar nga nëna e saj.
- iii. Në pyetësorin standard, në faqen nr. 10 të tij, subjekti ka deklaruar se si burim për shlyerjen e pjesshme të huas të shtetasit I. H ka shërbyer edhe shuma prej 10,000 euro, të dhënë dhuratë nga nëna e saj.
- iv. Subjekti e ka plotësuar deklaratën periodike të vitit 2012, në datën 28.3.2013, ndërsa shlyerjen e pjesshme të huas ndaj shtetasit I. H e ka kryer në datën 22.3.2013.

Fakti që deklarata periodike e vitit 2012 është plotësuar nga subjekti më vonë se kthimi i huas shtetasit I.H, duket sikur ka krijuar bindjen tek ajo se për sa kohë në momentin e plotësimit të

³⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 23.4.2020, të ILDKPKI-së.

deklaratës shuma 10,000 euro nuk ishte gjendje *cash*, nuk kishte detyrimin ligjor për të deklaruar shtesë të gjendjes *cash* të saj për vitin 2012.

25.63. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i shumës 10,000 euro si kursim *cash* në deklaratën e vitit 2012, por vetëm si dhuratë nga e ëma, mbetet një pasaktësi në deklaratën periodike vjetore, e cila bazuar në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³⁵ nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive. Subjekti, përdorimin e shumës 10,000 euro, e ka saktësuar dhe plotësuar me shpjegimet e dhëna në këtë kuadër, sipas legjislacionit të kohës me anë të akteve/procesverbaleve të kontrollit pranë organit kompetent ILDKPKI, shpjegime të cilat shërojnë këtë defekt në raport me provueshmërinë e faktit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* përdorimin e kësaj shume për shlyerjen e huas së shtetasit I.H, duke mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në pyetësorin standard por edhe gjatë hetimit.

Komisioni konstaton se subjekti justifikon me burime të ligjshme krijimin e kursimeve *cash* në shumën 10,000 euro në vitin 2012, pasi nga analiza financiare e vitit 2012³⁶ rezulton me një rezultat pozitiv në shumën 2,090,924.11 lekë, si dhe nëna e saj ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e kësaj dhurate.

25.64. Në përfundim, duke marrë në konsideratë argumentet e mësipërme, mungesën e investimeve të tjera në vitin 2012 të subjektit, me përjashtim të blerjes së banesës në korrik të vitit 2012 (përpara përfitimit të dhuratës në shumën 10,000 euro), rezultatit në vlerën 2,090,924.11 lekë të analizës financiare të vitit 2012, provimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të nënës së subjektit për të dhuruar shumën 10,000 euro, mungesës së burimeve të ligjshme për shlyerjen e huas në vitin 2013 në vlerën -1,233,619.33 të subjektit, e cila është për afërsisht shuma 10,000 euro e pretenduar prej saj si gjendje *cash* në vitin 2013, si dhe referuar vendimit nr. 37/2021³⁷ të Kolegjit dhe qëndrimit të këtij të fundit të mbajtur në vendimin nr. 1/2022 në lidhje me pasaktësitë në deklaratimet periodike të mosdeklarimit të gjendjes *cash*, Komisioni vendosi të konsiderojë në analizë financiare shumën 10,000 euro. Komisioni vlerëson të çmojë si pozitiv faktin se subjekti ka deklaruar dhurimin e kësaj shume në DVP/2012 dhe fakti se nuk e ka deklaruar këtë dhurim si gjendje *cash* nuk mund ta penalizojë.

Si rrjedhojë e përfshirjes në analizë financiare të vlerës 10,000 euro, analiza lidhur me shlyerjen e pjeshme të huas ndaj shtetasit I. H ka rezultat pozitiv, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 10.

	Mars 2013
PASURIA	-1,383,808.66
Automjeti “Peugeot **”	
<i>Ndryshim likuiditeti (pakësim i kursimeve 10,000 euro, dhuratë nga N. B)</i>	-1,383,808.66
DETYRIME	-1,561,485.24
Pagesë e huas nga I.H	-1,500,000.00
Pagesë e huas nga S.A	
Pagesa të kredisë bankare	-61,485.24

³⁵ Vendimet: nr. 9/2020; nr. 16/2020; 28/2020; nr. 31/2020; nr. 24/2021; dhe nr. 25/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

³⁶ Shihni pikën 31.4 të këtij vendimi.

³⁷ Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklaratime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

PASURIA NETO	177,676.58
TË ARDHURA	482,281.25
Të ardhurat e subjektit	194,084.75
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit S. B	288,196.50
SHPENZIME	141,024.00
Shpenzime jetike	141,024.00
TIMS	
Mundësia për kursime	163,580.67

iv) Hua e marrë nga shtetasi S.A, në vlerën 1,200,000 lekë

25.65. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting* në lidhje me këtë hua, ka deklaruar: “*Hua e marrë nga shtetasi S.A, me qëllimin e blerjes së apartamentit, me vlerë 1,200,000 lekë. Është shlyer 100,000 lekë nga huaja. Mbetur pa u shlyer nga huaja 1,100,000 lekë*”.

25.66. Për të vërtetuar huan e marrë nga shtetasi S.A dhe aftësinë financiare e tij për dhënien e kësaj huaje, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dhe pyetësorit standard:

i. Deklaratë, shkresë e thjeshtë, për dhënie huaje datë 1.7.2012, sipas së cilës shtetasi S.A deklaroi se i ka dhënë shtetasit S.B një hua në shumën 1,200,000 lekë, me një afat 10-vjeçar dhe pa interes.

ii. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.12.2016, sipas së cilës shtetasi S.A deklaroi se në datën 1.7.2012 i ka dhënë bashkëshortit të subjektit shumën prej 1,200,000 lekësh për blerje shtëpie. Këtë shumë ia ka dhënë pa kamatë dhe për t’ia kthyer brenda datës 1.7.2022, me këste sipas marrëveshjes me njëri-tjetrin. Zoti A deklaroi se kësti i parë në shumën 100,000 lekë është paguar nga huamarrësi në datën 21.12.2016.

iii. Nxjerrje llogarie S.A nga “Tirana Bank”, për periudhën 1.1.2010 – 17.10.2016, sipas së cilës të ardhurat e përfutur nga puna e këtij shtetasi deri në datën 1.7.2012 janë në shumën 10,415.00 euro.

iv. Nxjerrje llogarie S.A nga “Raiffeisen Bank”, për periudhën 8.10.2009 – 17.10.2016, sipas së cilës të ardhurat e përfutur nga puna e këtij shtetasi deri në datën 1.7.2012 janë në shumën 2,154,321.26 lekë.

v. Vërtetim, datë 21.1.2020, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi të ardhurat e realizuara nga shtetasi S.A për periudhën shtator 2006 – korrik 2007 pranë subjektit “A”.

vi. Vërtetim, datë 21.1.2020, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi të ardhurat e realizuara nga shtetasi S.A për periudhën nëntor 2006 – korrik 2007 pranë subjektit “S.G.S. A”.

vii. Vërtetim, datë 21.1.2020, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi të ardhurat e realizuara nga shtetasi S.A për periudhën tetor 2006 – dhjetor 2007 pranë subjektit “A”.

25.67. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI³⁸ në lidhje me këtë huamarrje, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*S. A është shoku im i fëmijërisë. Mundësitë e tij financiare kanë qenë punësimi i tij ku ka pasur një pagë afërsisht 70,000 lekë dhe një punësim tjetër me një rrogë në 400 euro në muaj, për këtë paraqes edhe statemente bankare të tij në ‘Raiffeisen Bank’ dhe ‘Tirana Bank’. Edhe ky transaksion është kryer cash. Gjendja e detyrimit ka qenë po aq sa është deklaruar në shumën 1,200,000 lekë*”.

³⁸ Kërkesë nr. *** prot., datë 20.4.2021, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2021.

25.68. Për të vërtetuar të ardhurat e huadhënësit, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, pyetësorit standard dhe pyetësorit datë 20.9.2021, dokumentet si më poshtë vijon:

- *statement* bankar të “Raiffeisen Bank” të llogarisë në emër të shtetasit S.A;
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 21.1.2020;
- vërtetim për deklaratimet e të ardhurave vjetore nga puna në shtetin italian, për shtetasin B A, vëllai i shtetasit S.A, për vitet 2007 – 2013.

25.69. Lidhur me të ardhurat e vëllait të huadhënësit, z. B.A, në shtetin italian në shumën totale 67,353 euro, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar mënyrën se si këto të ardhura janë përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga huadhënësi S.A. Për pasojë, Komisioni nuk është ndalur në analizimin e të ardhurave të realizuara nga ky shtetas, si dhe nuk i ka përfshirë në analizën financiare.

25.70. Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me aftësinë financiare të shtetasit S.A për dhënien e huas. Nga hetimi i kryer ka rezultuar:

- a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2021, informon lidhur me të ardhurat nga paga të përfituara nga shtetasi S.A nga janari i vitit 2012 e në vijim.
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2021, informon se shtetasi S.A nuk rezulton i regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat.
- c) DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 4.6.2021, informon se shtetasi S.A nuk ka automjet të regjistruar në këtë institucion.
- d) Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, informon se shtetasi S.A nuk figuron i regjistruar në regjistrin tregtar.
- e) ASHK-ja³⁹ informon se shtetasi S.A ka në pronësi apartament me sip. 80.3 m², me nr. pasurie *** dhe garazh me sip. 13.1 m², me nr. pasurie ***, të përfituar me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 15.9.2020.

25.71. Komisioni kreu një analizë mbi mundësitë financiare të shtetasit S.A për dhënien e huas në favor të subjektit të rivlerësimit, nga e cila rezultoi se huadhënësi nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e kësaj huaje. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

25.72. Në prapësimet e saj, subjekti shpjegoi se shuma e dhënë hua nga shtetasi S.A ka si burim të ardhurat e tij nga paga, të cilat janë tërhequr dhe janë mbajtur *cash* prej tij. Ajo ka sqaruar se ky shtetas gjatë vitit 2011 ka hapur dy llogari bankare në shkurt të vitit 2011 në vlerat 2,750,000 lekë dhe 5,200 euro. Këto llogari bankare e kanë burimin nga kursimet e anëtarëve të tij të familjes, të siguruara si më poshtë:

i. Të ardhura nga emigracioni i vëllait të huadhënësit B.A, për të cilat ai ka vendosur dokumentacionin e plotë provues. Sipas këtij dokumentacioni, të ardhurat e përfituara për periudhën 2007 – 2012 rezultojnë në shumën rreth 68,000 euro.

ii. Aktiviteti tregtar restorant – nga viti 1991, babai i tij F.A ka pasur një aktivitet tregtar restorant në vendin e quajtur Agjencia Librazhd, i cili ka qenë në pronësi të familjes. Ky aktivitet tregtar ka qenë i regjistruar në zyrën e tatimeve me leje tatimpaguesi . ***, datë 19.12.1993. Për të vërtetuar këtë fakt, ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022, nga DRT-ja Elbasan.

iii. Të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, si vijon:

³⁹ Aplikim nr. ***, datë 12.7.2021, në portalin elektronik të ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.10.2021, e ASHK-së.

a. Në datën 26.10.2000, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., është shitur prona me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sipërfaqe 172 m², në pronësi të babait të huadhënësit, shitur në vlerën 2,500,000 lekë. Për këtë pasuri janë paguar detyrimet tatimore në shumën 25,000 lekë.

b. Në datën 22.11.2002, me kontratën nr. *** rep. nr. ***kol., është shitur prona nr. ***, vol. ** f. ***, z. k. ***, me përshkrimin “apartament banimi me sipërfaqe 64.1 m²”, në pronësi të prindërve të huadhënësit, shitur në vlerën 600,000 lekë. Për këtë pasuri janë paguar detyrimet tatimore në shumën 3,000 lekë.

Subjekti pretendon se shumat 2,750,000 lekë dhe 5.200 euro, që janë arkëtuar në llogaritë bankare të huadhënësit, së bashku me interesat e përfituara nga këto depozita, nuk duhet të përfshihet në analizën financiare, pasi këto të ardhura nuk janë të huadhënësit, por të familjarëve të tij. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka cituar edhe jurisprudencën e Kolegjit.

25.73. Bashkëlidhur prapësimeve të saj, subjekti ka depozituar dokumentacionin e mëposhtëm:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.3.2022, me deklarues S.A, i cili deklaron në lidhje me administrimin e kursimeve të vëllait dhe babait të tij në dy llogaritë bankare në BKT, të hapura në vitin 2011;
- shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2022, e DRT-së Elbasan, ku konfirmohet se shtetasi F A ka qenë i regjistruar pranë ish-Degës së Tatimeve Librazhd, me aktivitet “restorant”;
- kontratë shitblerjeje pasurie nr. ***, datë 22.11.2002, me palë shitëse F e B.A dhe palë blerëse L.B, së bashku me mandatarkëtimin datë 16.12.2002, për pagesën e tatimit në ZRPP. Vlera e shitjes së pasurisë rezulton 600,000 lekë;
- kontratë shitblerjeje pasurie nr. ***, datë 26.10.2000, me palë shitëse F.A dhe palë blerëse B.K, së bashku me mandatarkëtimin datë 26.10.2000, për pagesën e tatimit në ZRPP. Vlera e shitjes së pasurisë rezulton 2,500,000 lekë.

25.74. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, në lidhje me mundësinë e shtetasit S.A për t'i dhënë huan bashkëshortit të subjektit, Komisioni i është referuar vendimit nr. 20/2019⁴⁰ (JR) dhe vendimit nr. 15/2019⁴¹ (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar pasurinë e shtetasit S.A vetëm në kufijtë e huas së dhënë. Pas kalimit të barrës së provës, nga ana e tij u provua me dokumentacion provues se llogaritë bankare të hapura në vitin 2011 kishin si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme familjarëve të tij dhe të ardhurat e përfituara nga emigracioni i të vëllait. Në tabelën vijuese pasqyrohet mundësia për kursime e shtetasit S.A, ku janë përfshirë në analizë të ardhurat e

⁴⁰ “[...] për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur [...]”.

⁴¹ “[...] në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”.

përfitur nga familjarët e tij nga shitja e pasurive të paluajtshme dhe të ardhurat e mundshme të kursyera nga puna e të vëllait në Itali⁴².

Tabela nr. 11.

	Kumulative 2006 – 1.7.2012
Pasuri	3,643,398.05
Ndryshim likuiditeti	3,643,398.05
Të ardhura	9,065,837.79
Shtator 2006 – korrik 2007, punësuar në ***	139,680.00
7.12.2007 – 31.12.2007 (paga në BKT)	102,000.00
6.6.2008 – 7.11.2008, ***ALBANIA	173,957.00
Nëntor 2009 – dhjetor 2012, punësuar në *** Albania	1,445,260.15
Tetor 2009 – dhjetor 2011, punësuar në A	1,960,731.25
Të ardhura nga interesat bankare	163,013.47
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	3,100,000
Të ardhurat e kursyera nga z. B.A	1,981,195.92 ⁴³
Shpenzime	862,431.00
Shpenzime jetike	862,431.00
Mundësi për kursime	4,560,008.74

Duke marrë në konsideratë këto të ardhura, rezulton se shtetasi S.A pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1,200,000 lekë.

25.75. Në lidhje me shlyerjen e kësaj huaje, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Nga kjo hua është shlyer ndër vite në vlerën prej 1,100,000 lekësh. Ka mbetur pa shlyer vlera prej 100,000 lekësh. Si burim për shlyerjen e huas janë shfrytëzuar të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit”*.

25.76. Në deklarinimin periodik të vitit 2016 subjekti ka deklaruar shlyerjen e vlerës 100,000 lekë, ndërsa në deklarinimin periodik të vitit 2017 ka deklaruar shlyerjen e vlerës 350,000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 30.12.2017. Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësinë e subjektit për shlyerjet pjesore të huas ndaj shtetasit S. A, nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer shlyerjet pjesore.

25.77. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka administruar informacionin nga institucioni punëdhënës i subjektit të rivlerësimit, i cili informoi se mbi bazën e kallëzimit të shtetasit F.B⁴⁴ është regjistruar kallëzimi penal nr. *** i vitit 2014, ndaj shtetasve B.T dhe F.T. Ky kallëzim i ka kaluar për ndjekje subjektit të rivlerësimit, e cila, në datën 16.9.2014 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se mosmarrëveshja midis kallëzuesit dhe personave të kallëzuar ka natyrë juridiko-civile.

25.78. Duke marrë në konsideratë faktin se marrëdhënia kontraktore mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “H” sh.p.k. është finalizuar në vitin 2012, ndërsa kallëzimi i shtetasit F.B është bërë në vitin 2014, Komisioni vlerëson se hetimi i kësaj çështjeje nga subjekti i rivlerësimit nuk është kryer në kushtet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit

⁴² Nga analiza financiare e kryer, referuar të ardhurave të dokumentuara në shumën 67,353.05 euro, si dhe shpenzimeve jetike referuar faqes zyrtare të EuroStat, në shumën 38,197 euro, mundësia për kursime kumulative për vitet 2009 - 2012 është në shumën 16,373.54 euro.

⁴³ Kursi i këmbimit euro/lekë 121*16.373,54 euro.

⁴⁴ Shtetasi F.B është administrator dhe ortak i shoqërisë “K” sh.p.k.

nuk gjendej në kushtet e ekzistencës së njëanësisë së parashikuar nga nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale⁴⁵.

Tabela nr. 12 – analiza financiare për pasurinë “apartament”

	Pagesa 104,000 euro
	Korrik 2012
PASURIA	11,717,197.38
Apartament me sip. 87.3 m ² + verandë me sip. 73.5 m ²	14,530,880.00
Ndryshim likuiditeti	-2,813,682.62
DETYRIME	9,986,000.00
Huaja nga P.G 50,000 euro, afat 10 vjet	6,986,000.00
Huaja nga I.H, 3,000,000	3,000,000.00
Huaja nga S.A, 1,200,000	0.00
PASURIA NETO	1,731,197.38
TË ARDHURA	1,212,284.29
Të ardhurat e subjektit	551,328.75
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit S.B	632,097.08
Të ardhura nga interesa bankare nga depozita	28,858.46
SHPENZIME	278,126.92
Shpenzime jetike	278,126.92
TIMS	0.00
Mundësia për kursime	-797,040.00

25.79. Në analizë financiare nuk është përfshirë si burim huaja e marrë nga shtetasi S.A në vlerën 1,200,000 lekë, për sa kohë nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se huadhënësi gjendej në pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje. Për pasojë, nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit, në shumën 797,040 lekë.

25.80. Në përfundim, subjektit i kaloi barra e provës për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar blerjen e apartamentit.

25.81. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti parashittoi se pamundësia financiare e konstatuar nga Komisioni vjen si pasojë e mospërfshirjes së shumës prej 1,200,000 lekësh e dhënë hua nga shtetasi S. A, duke krijuar një rezultat artificial negativ për blerjen e këtij apartamenti. Subjekti thekson se ky shtetas ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të dhënë këtë hua, për rrjedhojë, kërkon përfshirjen e kësaj vlere në analizën financiare.

25.82. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej saj, vlerësoi të përfshijë vlerën 1,200,000 lekë në analizën financiare, duke konsideruar faktin që subjekti mundi të provojë se huadhënësi S.A ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas. Pasi ka pranuar pretendimet e subjektit, Komisioni kreu një analizë të re financiare, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 13.

Pagesa 104,000 euro	Korrik 2012
PASURIA	11,717,197.38
Apartament me sip. 87.3 m ² + verandë me sip. 73.5 m ²	14,530,880.00
Ndryshim likuiditeti	-2,813,682.62
DETYRIME	11,186,000.00
Huaja nga P.G 50,000 euro, afat 10 vjet	6,986,000.00

⁴⁵ Neni 26 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie, për rastet e parashikuara nga neni 17.

Huaja nga I.H 3,000,000	3,000,000.00
Huaja nga S.A 1,200,000	1,200,000.00
PASURIA NETO	531,197.38
TË ARDHURA	1,212,284.29
Të ardhurat e subjektit	551,328.75
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit S.B	632,097.08
Dhuratë nga nëna N.B, datë 6.9.2012	0.00
Të ardhura nga interesa bankare nga depozita	28,858.46
SHPENZIME	278,126.92
Shpenzime jetike	278,126.92
TIMS	0.00
Mundësia për kursime	402,960.00

25.83. Në përfundim, konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

26. Automjet⁴⁶ tip “Peugeot *”, me targa AA *** HA, regjistruar në emër të shtetasit S.B, me vlerë 170,000 lekë. Pjesë takuese: 50%.**

26.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Vërehet se automjeti është blerë minimalisht 100,000 lekë më pak se sa është blerë nga shitësi një vit më parë.

Hetimi⁴⁷/analiza ligjore - financiare i/e kryer nga Komisioni për këtë pasuri

26.2. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me kontratën e shitblerjes së automjeti nr. ***, datë 2.5.2014, ka blerë automjetin tip “Peugeot **” (vit prodhimi 2002) në vlerën 170,000 lekë. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, pagesa e çmimit të shitjes është kryer jashtë zyrës noteriale. Ky automjet rezulton të jetë blerë nga shitësi në datën 10.7.2013, me kontratën nr. ***, për vlerën 2,000 euro.

26.3. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në rubrikën “të dhëna konfidenciale” të DVP/2014, me përshkrimin “*Automjet marka ‘Peugeot’ tipi ***, vit prodhimi 2002, me targa AA *** HA (në emër të bashkëshortit), përfituar me kontratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2014*”.

26.4. Pas analizimit të dokumentacionit dhe kryerjes së analizës financiare, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultojnë paqartësi apo pamjaftueshmëri mjetesh financiare për këtë automjet.

27. Gjendje në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank”⁴⁸, në vlerën 21,578.76 lekë, në emër të shtetasit S.B. Pjesë takuese: 50%.

27.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti nuk ka deklaruar burim.

Hetimi⁴⁹/analiza ligjore - financiare i/e kryer nga Komisioni

⁴⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2014; kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2013; certifikatë pronësie automjeti me targa AA *** HA dhe leje qarkullimi.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.1.2020.

⁴⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie page nga “Raiffeisen Bank”, e datës 20.1.2017.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.1.2020, e “Raiffeisen Bank”.

27.2. Nga nxjerrja e llogarisë bankare e bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se kjo llogari kreditohet nga kalimi i pagës së tij dhe gjendja e llogarisë në datën 20.1.2017 ka qenë 21,578.76 lekë.

27.3. Nga hetimi nuk kanë rezultuar paqartësi apo dyshime.

28. Gjendje në llogarinë bankare⁵⁰ në “Credins Bank”, në vlerën 0.23 lekë, në emër të znj. Elfrida Bregova. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi⁵¹/analiza ligjore – financiare i/e kryer nga Komisioni

28.1. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank” rezulton se gjendja e llogarisë në datën 24.1.2017 ka qenë 0.23 lekë.

28.2. Nga hetimi nuk kanë rezultuar paqartësi apo dyshime.

29. Gjendje cash në banesë, në vlerën 200,000 lekë

Hetimi/analiza ligjore - financiare i/e kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë e subjektit për krijimin e gjendjes cash të deklaruar, nga e cila ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes cash të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

KONSTATIME TË TJERA

Në lidhje me vendbanimin e subjektit deri në vitin 2012

30. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Nga momenti që kam marrë detyrën dhe deri në vitin 2012 kam banuar në një apartament banimi me adresë në rrugën ‘Mine Peza’, pallati nr. ***, sh. *, Tiranë. Kam qenë me qira dhe pagesa ka qenë 20,000 lekë në muaj. Qiranë ia kam paguar z. L.D, i cili, mesa kam pasur dijeni, këtë apartament e kishte të vajzës së tij e cila jetonte familjarisht në SHBA. Nuk kam kontratë qiraje. Nga viti 2012 dhe aktualisht banoj në shtëpinë të cilën e kam blerë me kontratë shitblerjeje, me adresë rruga ‘F. P’, kompleksi ‘H’, shk. *, ap. **, Tiranë”.*

Ndërkohë, në shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe bashkëshorti i saj pranë ILDKPKI-së në datën 25.3.2016, kanë deklaruar: *“Në rrugën ‘Mine Peza’ kemi qënë me qira, kontrata qiraje të asaj kohe nuk kemi, mund të themi se kjo banesë ka qenë në pronësi të L.D”.*

Nisur nga deklaratimet e mësipërme, Komisioni ka përfshirë në analizë financiare shpenzimet e kryera ndër vite në lidhje me qiramarrjen.

31. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka kryer analizën financiare⁵² për subjektin e rivlerësimit, sipas së cilës ka qenë në pamundësi mjetesh financiare për vitin 2012 në shumën 2,112,154.70 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 821,869.95 lekë.

31.1. Në total, për periudhën 2006 – 2016, ka qenë në shumën 2,942,147.27 lekë. Për këtë pamundësi financiare, subjektit iu kalua barra e provës.

31.2. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka prapësuar duke evidentuar rrethanat që kanë sjellë këtë rezultat negativ:

⁵⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2017, të “Credins Bank”.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020 drejtuar bankave; shkresë kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 7.2.2020, e “Credins Bank”.

⁵² Referohuni rezultateve të hetimit dërguar subjektit.

i. Në lidhje me rezultatin negativ të vitit 2012, thekson se ka ardhur si rezultat i përfshirjes në analizën financiare të shumës 21,493.35 euro, për të cilën ka provuar përmes dokumentacionit se nuk është paguar nga bashkëshorti i saj dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të përfshihet në analizë. Gjithashtu, balanca negative e këtij viti ka ardhur edhe si rezultat i mospërfshirjes në analizën financiare të huas së dhënë nga shtetasi S.A. Për këtë shumë subjekti pretendon se ka provuar se shtetasi S.A ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien hua të shumës 1,200,000 lekë dhe, për rrjedhojë, duhet të përfshihet në analizën financiare.

ii. Në lidhje me rezultatin negativ të vitit 2013, thekson se ka ardhur si rezultat i mospërfshirjes së shumës 10,000 euro, të përdorur për shlyerjen e pjeshme të huas shtetasit I.H. Subjekti shprehet se pasaktësia e kryer në deklarinimin e vitit 2012 është korrigjuar prej saj në vitin 2016 në ILDKPKI dhe në deklaratën *Vetting*, ku e ka deklaruar këtë shumë si burim për shlyerjen e pjeshme të huas ndaj shtetasit I.H. Nëse kjo shumë përfshihet në analizë financiare, rezultati do të jetë pozitiv.

31.3. Komisioni analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit dhe vlerësoi të mos përfshijë në analizën financiare pagesën e datës 3.12.2012 në shumën 21,493 euro, për të cilën subjekti arriti të provojë me dokumentacion faktin se kjo shumë nuk është paguar në bankë nga bashkëshorti i saj. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi të përfshijë në analizën financiare huan e z. A, duke qenë se subjekti provoi se ai ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje. Në lidhje me përdorimin e shumës 10,000 euro si burim për shlyerjen pjesore të huas së marrë nga shtetasi I.H, Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit dhe e përfshiu këtë vlerë në burimet e përdorura për shlyerjen e huas ndaj këtij huadhënësi. Në përfundim të kësaj analize, subjekti nuk rezulton me mungesë burimesh financiare ndër vite.

31.4. Në vitin 2012, nga analiza financiare, subjekti rezulton me një rezultat pozitiv në vlerën 2,090,924.11 lekë. Në këtë analizë është përfshirë edhe vlera e dhuruar nga nëna e subjektit prej 10,000 euro.

31.5. Në vitin 2013, nga analiza financiare, subjekti rezulton me një rezultat pozitiv në vlerën 575,330.05 lekë, pasi në këtë vit është konsideruar si burim për shlyerjen pjesore të huas shtetasit I.H, në vlerën 10,000 euro.

Konkluzion për vlerësimin e pasurisë

32. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

32.1. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

32.2. Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve përkatëse.

32.3. Për sa më sipër, trupi gjyqës vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

33. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

33.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁵³ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

33.2. DSIK-ja informon gjithashtu se në datën 26.1.2017 subjektit të rivlerësimit Elfrida Th. Bregova i është revokuar viza amerikane. Kjo rrethanë nuk është pasqyruar në deklaratën për kontrollin e figurës, pasi subjekti e ka plotësuar në datën 25.1.2017, pra një ditë para revokimit të vizës, arsye që tregon se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ishte në dijeni të faktit, por në kompleksitetin e vlerësimit të figurës së znj. Elfrida Bregova ky fakt duhet të merret në konsideratë.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

33.3. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni ka verifikuar pasaportën e subjektit, nga ku rezulton se është pajisur me vizë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për një periudhë 3-vjeçare, 29.6.2016 – 26.6.2019. Kjo vizë rezulton e revokuar. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me arsyen e revokimit të vizës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

33.4. Në parashtrimet e saj, subjekti ka sqaruar se në datën 29 qershor 2016 ajo, bashkëshorti dhe dy fëmijët e tyre janë pajisur me vizë të tipit B1/B2⁵⁴, lëshuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, me afat 3-vjeçar. Subjekti shprehet se viza e saj dhe e bashkëshortit është revokuar në datën 26.1.2017, duke theksuar se fëmijëve nuk iu është revokuar viza amerikane. Subjekti sqaron se është telefonuar nga ana e përfaqësuesve të Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe u është kërkuar të paraqiten në Ambasadë së bashku me pasaportat. Ajo sqaron se është paraqitur në Ambasadë në datën 26.1.2017. Përfaqësuesit e Ambasadës kanë tërhequr pasaportën e subjektit dhe bashkëshortit të saj dhe në një moment të dytë i kanë njoftuar se kishin revokuar vizat, por pa dhënë një arsye lidhur me këtë revokim. Ata kanë shpjeguar se subjekti dhe bashkëshorti i saj mund të aplikonin përsëri për t'u pajisur me vizë.

Subjekti parashtron se nuk ka pasur mundësi ta deklarojë revokimin e vizës në formularin e figurës, pasi e ka plotësuar në datën 25.1.2017, pra një ditë para revokimit dhe, për rrjedhojë,

⁵³ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017.

⁵⁴ <https://travel.state.gov/content/travel/en/us-visa-information-resources/all-visa-categories.html>

deklarimi i saj është i saktë. Ajo thekson se është e drejta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të revokojë vizën të cilën e kanë dhënë, por ky revokim nuk mund të përbëjë shkak për të cenuar kriterin e figurës, pasi nuk parashikohet si shkak as në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, por as në nenet 34-39 të ligjit nr. 84/2016. Ajo shprehet se nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme, si dhe nuk është përpjekur të fshehtë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, rezulton duke plotësuar kështu të gjitha kriteret e parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 34-39 të ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me revokimin e vizës së subjektit të rivlerësimit nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, më konkretisht në vendimin nr. 2/2019 dhe nr. 4/2021, revokimi i vizës është përdorur si shkak për të penalizuar për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit në rastet kur subjektet nuk e kishin deklaruar këtë revokim në deklaratën e kontrollit të figurës, duke u konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi, e cila sjell si pasojë papërshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, nga hetimi i Komisionit rezulton i provuar fakti se ajo e ka plotësuar dhe depozituar formularin e deklaramit të kontrollit të figurës në datën 25.1.2017, datë në të cilën ende nuk i ishte revokuar viza amerikane, duke e bërë deklaramin e saj të saktë dhe në përputhje me ligjin.

33.5. Në përfundim të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

33.6. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

34. Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

34.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

34.2. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

34.3. Gjetjet në lidhje me pesë dosjet penale të përzgjedhura me short

Komisioni, nga pesë dosjet e analizuara, i kërkoi shpjegime subjektit për dosjen 1 dhe 2, si më poshtë vijon:

Dosja 1 – kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 10.7.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Objekti i shortit është dokumenti ligjor vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, për kallëzimin penal nr. ***, mosfilluar në datën 18.9.2014. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese - arsyetuese dhe dispozitivi. Nga përmbajtja e tij konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Teksti është i qartë dhe i kuptueshëm. Vendimi përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Baza ligjore e vendimit të mosfillimit të procedimit penal është identifikuar drejt referuar rrethanave se si është paraqitur ngjarja. Ka përputhje midis pjesës arsyetuese të vendimit, bazës ligjore të identifikuar dhe dispozitivit. Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes të palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes.

Subjektit iu kërkuan shpjegime, pasi rezultoi se nuk ka zbatuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, pasi ka vendosur mosfillimin në tejkalim të afatit 30-ditor.

Në parashtrimet e paraqitura, subjekti vuri në dukje faktin se kallëzimi penal i regjistruar në datën 10.7.2014 është tërhequr prej saj në datën 21.7.2014, fakt i cili pasqyrohet edhe në fletën përkatëse të regjistrimit të kallëzimeve penale. Ajo shprehet se menjëherë pas marrjes së materialit i është drejtuar sektorit të PMNZSH-së pranë Prefekturës Tiranë, duke kërkuar kryerjen e aktekspertimit. Ky institucion ka kthyer përgjigje në datën 18.9.2014. Gjithashtu, subjekti sqaron se në periudhën 1.8.2014 – 31.8.2014 ka qenë me leje vjetore dhe nuk mund të kryente veprime procedurale.

Referuar fletës së regjistrimit ku pasqyrohet tërheqja e kallëzimit penal nga ana e subjektit të rivlerësimit, rezulton se dosja hetimore është tërhequr prej saj në datën 21.7.2014. Duke marrë në konsideratë faktin se në periudhën e procedimit janë përfshirë edhe pushimet e muajit gusht, si dhe faktin që shkresa e PMNZSH-së ka ardhur në datën 18.9.2014, subjekti ka shpjeguar bindshëm arsyet e vonës në vendimin e mosfillimit.

Dosja 2 – procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 29.3.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Objekti i shortit është dokumenti ligjor, vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 3.7.2014, për procedimin penal nr. ***.

Në datën 3.7.2014 subjekti i rivlerësimit Elfrida Bregova ka përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”, në mbështetje të nenit 328, pika 1, germa “dh” e Kodit të Procedurës Penale, ku ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. 1763 të vitit 2013, për veprën penale të “mashttrimit”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, pasi nuk mund të provohet kryerja e veprës penale.

Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese - arsyetuese dhe pjesa konkluduese.

Nga përmbajtja e aktit procedural “Vendim pushimi”, konstatohet se janë respektuar përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit. Teksti është i kuptueshëm. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit.

Baza ligjore e identifikuar është e saktë. Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes të palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë, sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit së çështjes.

Sa vërehet nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim pushimi ka kaluar një kohë e gjatë rreth 15 muaj. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit si procedim penal në prill vitit 2013 ka urdhëruar policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore me afat të përcaktuar 1 muaj. Rezulton se për një periudhë 3-mujore policia gjyqësore nuk ka realizuar veprimet sipas urdhrit për delegim dhe më tej janë kryer disa prej tyre. Në material konstatohet se është kryer edhe zëvendësimi i oficerit të policisë gjyqësore. Shkak tjetër për kohëzgjatjen e hetimeve kanë qenë edhe veprimet të cilat i janë deleguar policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Dibër, si dhe kërkimi për gjetjen dhe pyetjen e personave, deklaratimet e të cilëve përbënin interes për hetimin.

Nga shkresa nr. ***, datë 14.8.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk rezulton që ndaj vendimit të pushimit të ketë vendim gjyqësor.

Subjektit iu kërkuan shpjegime, pasi rezultoi se ka zgjatur hetimet paraprake për një periudhë 15-mujore, duke mos i dhënë zgjidhje procedimit brenda një afati të arsyeshëm.

Në parashtrimet e paraqitura, subjekti ka argumentuar se për hetimin e këtij procedimi penal është ngarkuar një oficer i policisë gjyqësore i cili është larguar nga detyra dhe më pas dosja i ka kaluar për hetime një oficeri tjetër. Ajo gjithashtu ka parashtruar se është kërkuar disa herë njoftimi i personave që kishin dijeni për faktin dhe njoftimi është kryer me shkresa drejtuar komisarivateve përkatëse, sipas vendbanimit të deklaruar, dhe është pritur ardhja e përgjigjeve me shkresë. Dosja është deleguar edhe në Prokurorinë e Rrethit Dibër për të kryer disa veprime hetimore. Hetimet janë zgjatur për shkak të kryerjes së veprimeve hetimore për të zgjidhur në mënyrë sa më të drejtë çështjen. Vendimi u është njoftuar palëve rregullisht dhe rezulton se ndaj këtij vendimi të prokurorisë nuk ka një vendim gjyqësor, që do të thotë se palët nuk e kanë ankimuar atë.

Referuar materialeve të dosjes hetimore rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer në vijimësi veprime hetimore për këtë procedim. Gjithashtu konstatohet edhe problematika e hasur në lidhje me gjetjen dhe identifikimin e personave të cilët duhet të merreshin në pyetje gjatë procesit hetimor, si dhe delegimi për urdhërimin e kryerjes së veprimeve hetimore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër. Për sa më sipër, shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë procedim rezultojnë bindëse.

ANALIZA E GJETJEVE

34.4. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se subjekti i rivlerësimit, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara, konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur

afatin e kryerjes së tyre. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e saj bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provat e mbledhura, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga vështrimi i të dhënave statistikore rezulton se subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 967 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) materiale. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe disponimin e gjykatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurore Elfrida Bregova. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është

konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Elfrida Bregova për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”. Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Elfrida Bregova rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër.

35. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

35.1. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e:

- i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLP-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij;
- ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese;
- iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

35.2. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së.

35.3. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

36. Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

Në Komision janë paraqitur 8 denoncime, nga të cilat subjekti i janë kërkuar shpjegime për dy denoncimet si më poshtë vijon:

Denoncim i shtetas Sh.C⁵⁵

Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka vendosur në mënyrë të gabuar “mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin e bërë nga denoncuesja. Ajo pretendon gjithashtu se nuk është njoftuar për këtë vendim të subjektit, por pas shumë kërkesave drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ka mundur të marrë dijeni për vendimin e “mosfillimit të procedimit penal”.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2019 dhe shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2019.

Pasi ka shqyrtuar fashikullin e kallëzimit penal nr.***, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka njoftuar në kohë kallëzuesin lidhur me vendimin për mosfillimin e procedimit penal, në përputhje me përcaktimet e nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë konstatim.

Në parashtrimet e paraqitura, subjekti argumenton se njoftimi i vendimit kallëzueses apo ankueses nuk është detyrë e prokurorit të çështjes. Në Kodin e Procedurës Penale parashikohet se ky vendim u njoftohet menjëherë kallëzuesve apo ankuesve, por nuk ngarkon posaçërisht prokurorin me detyrimin ligjor për kryerjen e procedurës së njoftimit të vendimit. Ajo sqaron se në rastet e mosfillimit të procedimit penal, pas marrjes së vendimit dhe lidhjes së dosjes nga sekretaria e prokurorisë, dosja dorëzohet te drejtuesi i seksionit përkatës, i cili më pas e përcjell te Drejtuesi i Prokurorisë, nën emrin dhe kundrejt nënshkrimit të të cilit dalin të gjitha aktet (njoftime, kërkesa etj.) nga organi i prokurorisë. Më pas dosja kalon në sektorët përkatës të statistikave, të cilët bëjnë shënimet përkatëse në regjistrat e statistikave dhe dosja kalon në zyrën e sekretarisë, e cila ka për detyrë t'ua dërgojë njoftimet e vendimeve kallëzuesve apo ankuesve. Më pas i kalon njoftimi shërbimit postar, i cili duhet t'ia dorëzojë njoftimin ankuesit në adresën e dhënë.

Komisioni vlerëson se pavarësisht shpjegimeve të subjektit, ajo duhet të ishte treguar më e kujdesshme për të marrë të gjitha masat e nevojshme për njoftimin në kohë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

Denoncim i shtetases L.L⁵⁶

Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetimet e nevojshme për të verifikuar dokumentacionin e pretenduar si të falsifikuar.

Komisioni, pasi administroi procedimin penal nr. ***, konstatoi se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar çështja civile nr. ***, me palë paditëse av. K.B dhe palë të paditur L.L, me objekt “përmbushje detyrimi kontraktor sipas kontratës së porosisë datë 15.1.2010”. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje civile, nga sistemi TIMS ka rezultuar se në datën 15.1.2010 pala e paditur ka qenë jashtë territorit shqiptar. Gjatë gjykimit ka rezultuar gjithashtu se palët kontraktore, pasi kanë vendosur nënshkrimet në draftin e kontratës së porosisë, janë paraqitur pranë noteres E. Q për noterizimin e saj. Kjo notere ka refuzuar të kryejë këtë shërbim pasi kontrata nuk i plotësonte kushtet për noterizim. Më tej, në datën 12.3.2013 av. K.B është paraqitur pranë noteres G.B ku ka kryer “vërtetimin e njësimin me origjinalin” të kontratës së porosisë. Duke pasur dyshime mbi origjinalitetin e kontratës, gjykata ka pezulluar gjykimin dhe është paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kryer një sërë veprimesh hetimore, duke përfshirë këqyrjen e dosjes civile, kryerjen e ekspertimit grafik dhe marrjen në pyetje të personave që kanë pasur dijeni për rrethanat e hetimit. Në datën 4.4.2014 subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal, pasi fakti/falsifikimi nuk ekziston.

Ndaj vendimit të subjektit për pushimin e procedimit është ushtruar ankim në Gjykatë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Në zbatim të vendimit të gjykatës janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara dhe në datën 17.2.2016 subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar sërish ankim nga kërkuesja dhe Gjykatë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 7.10.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2017.

ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin datë 21.1.2019, ka urdhëruar kthimin e akteve në prokurori për hetime të mëtejshme.

Në datën 25.2.2019 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për heqje dore dhe zëvendësimin e saj si prokurore e çështjes, duke argumentuar se nga ana e saj janë dhënë dy vendime për këtë çështje dhe për të shmangur çdo lloj aludimi për njëanshmëri. Procedimi i ka kaluar në ndjekje një tjetër prokurori, i cili ka vendosur gjithashtu pushimin e hetimeve për këtë procedim penal.

Duke iu referuar kronologjisë së vendimmarrjeve për këtë procedim, Komisioni i ka kërkuar subjektin shpjegime në lidhje me kthimin (dy herë) nga ana e gjykatës të akteve për hetime të mëtejshme.

Në parashtrimet e paraqitura, subjekti ka argumentuar se gjatë hetimit të këtij procedimi penal kjo çështje është zgjidhur civilisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 3.10.2014, me të cilin është vendosur pranimi i padisë së paditësit K.B dhe detyrimi i të paditurës L.L të përmbushë detyrimin kontraktor sipas kontratës midis palëve, vendim ky i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 14.5.2015. Pra, gjatë kohës që ky procedim penal ka qenë në hetim nga prokuroria, konflikti civil në thelbin e tij, i cili është bërë shkak për nisjen e procedimit penal, është zgjidhur në themel nga gjykatat civile.

Pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti duhet të zbatonte detyrat e përcaktuara nga gjykata e apelit në dy vendimet e dhëna prej saj, duke kryer veprime të mëtejshme hetimore. Mungesa e kryerjes së këtyre veprimeve vlerësohet si mospërmbushje e detyrave të përcaktuara nga gjykata. Në përfundim, në lidhje me këtë procedim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur plotësisht detyrimet e saj si prokurore e çështjes.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional

37. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

37.1. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

37.2. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, në datën 8.4.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha